- d. Është planifikuar të zhvillohet të paktën 1 trajnim për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim për të miturit, me pjesëmarrjen e x% deri në x% të prokurorëve dhe x% deri në x% të punonjësve të policisë gjyqësore të seksioneve të të miturve.


94. Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur kur:**

- a. Numri i rasteve kur prokuroria ka kërkuar përcaktimin e alternativave të dënimit me burgim është më i ulët se xx% në raport me numrin e rasteve kur prokuroria ka kërkuar burgimin e të pandehurve, në total dhe veçmas për të miturit;
- b. Prokurori i Përgjithshëm nuk ka miratuar asnjë udhëzim të përgjithshëm për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim;
- c. Nuk është zhvilluar asnjë trajnim për zbatimin e dënimeve alternative ose në trajnim kanë marrë pjesë më pak se x% e prokurorëve dhe x% e punonjësve të policisë gjyqësore në detyrë;
- d. Nuk është zhvilluar asnjë trajnim për zbatimin e dënimeve alternative për të miturit ose në trajnim kanë marrë pjesë më pak se x% e prokurorëve dhe x% e punonjësve të policisë gjyqësore të seksioneve të të miturve.

(f) Rritja e zbatimit praktik në lidhje me format e veçanta të gjyqimit

95. Rekomandohet rritja e zbatimit praktik të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me instrumentet procedurale dhe format e veçanta të gjyqimit, si një mjet për të rritur efektivitetin e procesit penal dhe për të zvogëluar numrin e çështjeve të prapambetura në sistemin gjyqësor, me qëllim përfundimin e çështjeve brenda një afati kohor të arsyeshëm.

(i) Të dhënat që duhet të mbliidhen





96. Numri i kërkesave për dërgimin e çështjeve në gjykim para gjykatës.
97. Numri i kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, në raport me numrin e kërkesave totale për dërgimin e çështjeve gjyqësore për gjykim në gjykatë; Numri i çështjeve ku gjykatat kanë pranuar kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë në raport me numrin total të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë.
98. Numri i kërkesave për miratimin e urdhrit penal, në lidhje me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim.; Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e urdhrit penal në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e urdhrit penal.
99. Numri i kërkesave për miratimin e kërkesave për marrëveshje të pranimit të fajësisë, në lidhje me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim; Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë.

(ii) Vlerësimi

100. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:
- a. Numri i kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim, është më i lartë se x%. Numri i rasteve ku gjykatat kanë pranuar kërkesat për gjykim të drejtpërdrejtë në raport me numrin e përgjithshëm të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë është më i lartë se x%;
- b. Numri i kërkesave për miratimin e urdhrit penal, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim, është më i lartë se x%. Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e urdhrit penal në raport me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e urdhrit penal është më i lartë se x%;
- c. Numri i kërkesave për miratimin e kërkesave për marrëveshje të pranimit të fajësisë, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim është më i lartë se



x%; Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë është më i lartë se x%.

101. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Numri i kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim është midis x% dhe x%. Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për gjykim të drejtpërdrejtë në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë është midis x% dhe x%;
- b. Numri i kërkesave për miratimin e urdhrit penal, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim, është midis x% dhe x%. Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e urdhrit penal në raport me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e urdhrit penal është midis x% dhe x%;
- c. Numri i kërkesave për miratimin e gjyqimit me marrëveshje, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim është midis x% dhe x%; Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e aktgjyqimit me marrëveshje në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e aktgjyqimit me marrëveshje është midis x% dhe x%.

102. Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. Numri i kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim, është më i ulët se x%. Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për gjykim të drejtpërdrejtë në raport me numrin e përgjithshëm të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë është më i ulët se x%;
- b. Numri i kërkesave për miratimin e urdhrit penal, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e lëndëve për gjykim, është më i ulët se x%. Numri i rasteve kur gjykatat kanë




pranuar kërkesat për miratimin e urdhrit penal në raport me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e urdhrit penal është më i ulët se x%;

- c. Numri i kërkesave për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, në raport me numrin e kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim është më i ulët se x%; Numri i rasteve kur gjykatat kanë pranuar kërkesat për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë është më i ulët se x%.

(g) Të drejtat procedurale të personave nën hetim

103. Rekomandohet që prokuroria të ushtrojë kujdesin e duhur për të siguruar respektimin e të drejtave procedurale të personave nën hetim dhe të të pandehurve, duke përfshirë shmangien e ndalimeve arbitrare dhe të pajustificuara, si dhe kontrolleve dhe sekuestrimeve që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
104. Prokuroria duhet të sigurojë që çdo masë që kufizon lirinë, përfshirë ndalimin dhe arrestimin, të bazohet në prova të mjaftueshme dhe të jetë një masë e drejtpërdrejtë dhe e nevojshme për kryerjen e hetimeve.
105. Konfiskimet dhe kontrollet duhet të kryhen vetëm kur janë të justifikuara, proporcionale dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe standardet e të drejtave të njeriut. Rekomandohet që prokuroria të ndërtojë kapacitete për të siguruar që të gjitha veprimet procedurale të dokumentohen dhe mbikëqyren, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie të proceseve.
106. Përdorimi i masave të tilla duhet të kontrollohet gjithmonë nga organet gjyqësore dhe të mbështetet në arsyetim të plotë dhe të arsyetuar përpara se të merren. Rekomandohet gjithashtu forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, për të parandaluar çdo abuzim dhe për të siguruar që çdo masë që kufizon lirinë të respektojë të drejtat e individëve dhe të plotësojë kriteret e ligjshmërisë.




Elementet	Të dhënat që duhet të mblidhen
Ndalimet dhe arrestimet	<ul style="list-style-type: none"> - Numri total i kërkesave për vleftësimin e urdhrave të ndalimeve të nxjerra nga prokurorët; - Numri total i kërkesave për vleftësimin e rasteve të ndalimit me iniciativë të kryer nga oficerët e policisë gjyqësore; - Numri total i kërkesave për vleftësimin e arresteve në flagrancë; - Numri total i kërkesave për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”/arrest në shtëpi të kërkuara nga prokuroria; - Numri total i kërkesave për caktimin e masave të tjera të sigurimit personal me karakter shtrëngues të kërkuara nga prokuroria - Numri i vendimeve gjyqësore për vleftësimin e paligjshëm të ndalimeve/arrestimeve <p>Numri total i rasteve të lirimit të menjëhershëm të vendosur nga prokurori.</p>
Kontrollet dhe sekuestrimet	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i përgjithshëm i kërkesave për lejimin e kontrolleve/sekuestrimeve të kërkuara nga prokuroria; - Numri i rasteve kur këto kërkesa janë pranuar/refuzuar nga gjykata - Numri i rasteve të ankimit ndaj vendimeve të kontrollit/sekuestrimit nga subjektet
Arsyetimi dhe dokumentimi	<ul style="list-style-type: none"> - Përqindja e masave procedurale të lejuara nga gjykata sipas llojit (kontrolle, ndalime, sekuestrime, përgjime)
Mekanizmat e kontrollit	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i rasteve kur është ushtruar kontroll në lidhje me caktimin e masave të sigurimit personal për pretendime për shkelje të të drejtave gjatë procedurave hetimore
Trajnime dhe udhëzime	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i trajnimeve mbi të drejtat procedurale dhe zbatimin e masave kufizuese - Ekzistenca e udhëzimeve të brendshme për zbatimin proporcional dhe të ligjshëm të këtyre masave

(i) **Vlerësimi**

107. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:



- a. Numri i masave kufizuese plotësisht të justifikuara dhe të dokumentuara (ndalime, kërkitime, konfiskime) është më i lartë se x%;
 - b. Numri i kërkesave për masa kufizuese të refuzuara nga gjykatat si të pajustificuara është më i ulët se x%;
 - c. Ekzistojnë udhëzime të brendshme dhe janë mbajtur të paktën x trajnime kombëtare;
 - d. Ka patur raste verifikimi të veprimtarisë dhe nuk janë konstatuar raste të shkeljes procedurale ose numri i rasteve është më i ulët se viti paraardhës.
108. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:
- a. Numri i masave procedurale të pranuar nga gjykata (ndalimet, kërkimin, konfiskimet) është midis x% dhe x%;
 - b. Numri i kërkesave për masa kufizuese të rrëzuar nga gjykatat është midis x% dhe x%;
 - c. Ekzistojnë udhëzime të brendshme, por zbatimimi është i pjesshëm, ose trajnimi ka përfshirë më pak se 50% të prokurorëve;
 - d. Nuk ka patur raste kontrolli të brendshëm për raste të evidentuara ose ankime të subjekteve për shkelje procedurale.
109. Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:
110. Numri i masave procedurale të pranuar nga gjykata (ndalime, kërkitime, konfiskime) është më i ulët se x%;
111. Numri i kërkesave për masa kufizuese të refuzuara nga gjykatat është më i lartë se x%;
112. Nuk ka udhëzime të brendshme dhe nuk janë mbajtur trajnime;
113. Rezulton një numër i lartë rastesh ku janë evidentuar shkelje procedurale ose numër i lartë ankimesh nga subjektet procedurale.



(h) Informimi publik dhe transparencja prokuroriale

114. Rekomandohet përditësimi i materialeve informuese për publikun dhe palët e përfshira mbi procedurën penale, me qëllim rritjen e transparencës, kuptueshmërisë dhe aksesit efektiv në drejtësi. Materialet informuese duhet të jenë të qarta, të përditësuara dhe të përshtatura për kategori të ndryshme të qytetarëve, duke përfshirë personat nën hetim, të pandehurit, viktimat e veprave penale dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë në zbatim të parashikimeve procedurale penale lidhur me sekretin hetimor dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave procedurale. Përmirësimi i aksesit në informacion ndihmon në garantimin e të drejtave procedurale, zvogëlon pasigurinë juridike dhe rrit besimin e publikut në sistemin e drejtësisë penale. Rekomandohet gjithashtu që materialet të jenë të disponueshme në formate të ndryshme, duke përfshirë dixhitalisht dhe në gjuhë të thjeshtuar, kur është e nevojshme.
115. Është detyrë themelore e organit të prokurorisë të sigurojë që publiku të jetë i informuar në mënyrë adekuate për të drejtat procedurale, të përcaktuara me nenin 61 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar. Ky ligj urdhëron në mënyrë të qartë që shërbimet e marrëdhënieve me publikun brenda prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm duhet t'u ofrojnë informacion publikut dhe medias në lidhje me aktivitetet e prokurorisë, duke mbështetur njëkohësisht kërkesat ligjore të hartuara për të garantuar sekretin dhe integritetin e hetimeve në vazhdim. Këto shërbime veprojnë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e një prokurori të emëruar, me një theks të fortë në balancimin e të drejtës për informacion kundrejt nevojës për të mbrojtur dinjitetin njerëzor, privatësinë, reputacionin dhe prezumimin e pafajësisë. Për më tepër, Drejtuesi i Prokurorisë duhet të caktojë një Zyrar të Marrëdhënieve me Publikun Civil për të koordinuar pajtueshmërinë me legjislacionin mbi të drejtën e informimit. Është e rëndësishme të theksohet se prokuroria nuk është e autorizuar të ofrojë këshillim ligjor ose shërbime të ndihmës ligjore. Duke marrë parasysh këto detyrime statutore, këshillohet të rishikohen dhe të përmirësohen potencialisht praktikat aktuale për t'u përafruar më mirë me kërkesat e ligjit për transparencë dhe komunikim efektiv në marrëdhëniet me publikun, duke forcuar kështu besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.



Elementet	Të dhënat që duhet të mblidhen
Përditësimi i materialeve	<ul style="list-style-type: none"> - Lista e materialeve informuese ekzistuese - Viti i fundit i përditësimit të secilit material - Numri i materialeve të reja/ të përditësuara për vitin kalendarik
Llojet e materialeve dhe tematika	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i përgjithshëm i materialeve të publikuara për veprimtarinë e prokurorisë - Temat e mbuluara (hetimi, të drejtat e të pandehurve, viktimat, afatet, etj.) - numri i materialeve për kategori të caktuara (të mitur, viktimat, të huaj, etj.)
Formatet e shpërndarjes	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i materialeve të publikuara në internet në faqen zyrtare - Disponueshmëria e materialeve në gjuhë të thjeshtuar ose të përkthyer - mundësia e aksesit të materialeve në formë fizike

(i) **Vlerësimi**

116. Rekomandimi konsiderohet i **përbushur** kur:

- a. Të paktën x% e materialeve ekzistuese janë përditësuar në 12 muajt e fundit;
- b. Janë hartuar materiale që përfaqësojnë të gjitha kategoritë kryesore (personat nën hetim, viktimat, të miturit, të huajt, etj.);
- c. Të gjitha materialet janë në dispozicion në formë dixhitale dhe fizike;
- d. Janë përgatitur materiale në gjuhë të thjeshtuar ose të përkthyer për grupet vulnerabël;

117. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përbushur** kur:

- a. Midis x% dhe x% të materialeve janë përditësuar;
- b. Janë publikuar disa materiale, por jo të gjitha kategoritë janë të mbuluara;



- c. Disponueshmëria është vetëm në një nga formatet (dixhitale ose fizike);
- d. Nuk ka ende gjuhë të thjeshtuar ose përkthime të plota.
- e. Rekomandimi konsiderohet **i papërbushur** kur:
- f. Më pak se x% e materialeve janë përditësuar ose nuk ka pasur përditësime në 12 muajt e fundit;
- g. Nuk ekzistojnë materiale të përshtatura sipas kategorive të qytetarëve;
- h. Materialet nuk janë të aksesueshme as në internet dhe as në formë fizike;
- i. Nuk ka përmbajtje në gjuhë të thjeshtuar ose në gjuhë të tjera për komunitetet jo-shqipfolëse.

(i) Forcimi i luftës kundër kriminalitetit

- 118. Rekomandohet rritja e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon minimal), me qëllim rritjen e rolit aktiv të prokurorit, dhe jo thjesht të vihet në lëvizje nëpërmjet njoftimeve të bëra nga të tjerët.
- 119. Një përgjigje e fuqishme ndaj krimeve të rënda, veçanërisht atyre veprave penale që kërcënojnë integritetin dhe sigurinë e shtetit, është thelbësore për të ruajtur shtetin e së drejtës dhe për të siguruar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Për këtë qëllim, rekomandimi thekson nevojën për një qasje proaktive të prokurorisë, duke kaluar nga marrja pasive e referimeve në fillimin aktiv të hetimeve për aktivitete të rënda kriminale. Prokurorët duhet të fuqizohen dhe të kenë burime për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur çështjet që kanë pasoja të gjera për institucionet shtetërore, sigurinë publike dhe stabilitetin shoqëror. Kjo përfshin ngritjen sistematike të kapaciteteve, trajnimin e synuar dhe zhvillimin e planeve strategjike të punës që i japin përparësi rasteve me ndikim të lartë. Për më tepër, standardet transparente - të tilla si një rritje vjetore e demonstrueshme e procedimeve të vetë-iniciuara dhe një përqindje në rritje e rasteve të tilla në raport me totalin - janë të domosdoshme për matjen e progresit. Duke përforcuar këto praktika



prokuroriale dhe duke vendosur metrika të qarta për llogaridhënien, sistemi i drejtësisë mund të pengojë dhe shpërbëjë në mënyrë më efektive grupet e strukturuar kriminale, korrupsionin dhe format e tjera të krimit të rëndë që dëmtojnë themelet e shtetit.

120. Pavarësisht nevojës së qartë për një qasje më proaktive nga ana e prokurorisë, vështirësi të konsiderueshme dhe të natyrshme vijnë të pengojnë vënien në zbatim të këtyre rekomandimeve. Kalimi nga një model reaktiv në një model vetë-iniciues të hetimit kërkon jo vetëm një transformim thelbësor kulturor brenda zyrave të prokurorisë, por edhe një investim të konsiderueshëm në burime, trajnim dhe planifikim strategjik. Prokurorët mund të përballen me kufizime që rrjedhin nga fuqia punëtore e kufizuar, ngarkesa të larta pune ose mungesa e ekspertizës së specializuar për të identifikuar dhe ndjekur çështje komplekse me ndikim të lartë pa shtysë të jashtme. Për më tepër, pengesat strukturore, si inercia burokratike, mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional dhe presioni për të ruajtur norma të larta dënimi, mund të dekurajojnë nisjen e çështjeve të reja dhe sfiduese. Prezantimi i standardeve transparente dhe objektivave vjetore të progresit, ndonëse vendimtar për llogaridhënien, përbën gjithashtu sfida në matje, pasi ndryshueshmëria e kompleksitetit të çështjeve dhe natyra gjithnjë në zhvillim e veprimtarisë kriminale nuk maten gjithmonë plotësisht nga treguesit sasiorë. Këto pengesa shumë-dimensionale theksojnë rëndësinë e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të mbështetur mirë ndaj reformës, që balancon ambicien me realitetet praktike në terren.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen


121. Numri vjetor i procedimeve penale të regjistruara nga prokuroria (në total);
122. Numri dhe përqindja e procedimeve të regjistruara kryesisht nga prokuroria në raport me totalin. Krahasimi me vitin e kaluar.
123. Numri dhe përqindja e çështjeve të nisura mbi bazë referimesh nga Policia e Shtetit, kallëzime nga nëpunësit shtetërorë, personeli mjekësor ose nga shtetas/persona juridikë
124. Rritja ose ulja e përqindjes së procedimeve penale të nisura kryesisht krahasuar me vitin paraardhës (në vlerë dhe përqindje).



125. Është një detyrim themelor ligjor për prokurorët që të veprojnë jo thjesht si marrës pasivë të çështjeve, por si mbrojtës vigjilentë të ligjit, duke identifikuar dhe ndjekur në mënyrë proaktive sjelljen kriminale që kërcënon rendin publik dhe integritetin e shtetit. Për të përmbushur këtë mandat në mënyrë efektive, është thelbësore zbatimi i udhëzimeve të forta, programeve gjithëpërfshirëse të trajnimit dhe planeve strategjike të punës. Këto instrumente i pajisin prokurorët me aftësitë, njohuritë dhe qartësinë procedurale të nevojshme për të nisur hetime kryesisht me nismën e tyre, dhe jo të mbështeten vetëm në referime të jashtme. Trajnimet e rregullta përmirësojnë aftësitë hetimore dhe aftësinë për t'u përshtatur, ndërsa planet e qarta të punës vendosin përparësi dhe garantojnë veprim të sistemuar. Hartimi dhe shpërndarja e këtyre udhëzimeve rrit standardet e punës së prokurorisë, nxit një kulturë iniciative dhe siguron përputhshmëri si me detyrimet ligjore ashtu edhe me praktikën më të mira. Si përfundim, kjo qasje proaktive forcon rolin kyç të prokurorisë në mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe përparimin e drejtësisë.

(ii) **Vlerësimi**

126. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:
- a. Numri i procedimeve penale të nisura kryesisht nga prokuroria ka një rritje të qëndrueshme vjetore prej të paktën x% krahasuar me një vit më parë;
 - b. Përqindja e procedimeve penale të nisura kryesisht arrin të paktën x% të totalit të procedurave të regjistruara;
 - c. Janë marrë masa konkrete për të promovuar këtë formë hetimi (udhëzime, orientime për prokurorët, analiza vjetore e trendeve).
127. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:
128. Rritja e procedimeve penale të nisura kryesisht është midis x% dhe x% krahasuar me vitin e kaluar;
129. Përqindja e procedimeve penale të nisura është kryesisht midis x% dhe x% të totalit;
130. Ka sinjale për përmirësim, por ende mungojnë masa strukturore ose udhëzime të mirëfillta.
131. Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:
- a. Numri i procedimeve penale të nisura kryesisht nuk ka ndryshuar ose është ulur krahasuar me vitin e kaluar;



- b. Përqindja e procedimeve penale të nisura është kryesisht nën x% të totalit të procedurave;
- c. Mungojnë masa konkrete për të inkurajuar këtë praktikë dhe nuk ka asnjë analizë të trendit.

(ii) Përmirësimi i cilësisë së hetimeve

132. Përmirësimi i cilësisë së hetimeve kundër korrupsionit, veçanërisht nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe rritja e numrit të kërkesave për dërgimin e çështjeve për gjykim. Rekomandohet forcimi i hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të rasteve të korrupsionit, veçanërisht në nivele të larta.
133. Gjatë vlerësimin e progresit, është thelbësore të analizohen të dhënat veçmas për SPAK-un dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Një ndarje e tillë e të dhënave lejon një vlerësim më të saktë të efektivitetit dhe cilësisë së përpjekjeve kundër korrupsionit brenda strukturave të specializuara dhe atyre të përgjithshme të prokurorisë. Duke shqyrtuar tregues kyç—përfshirë numrin e procedimeve penale të nisura, çështjet e përcjella për gjykim dhe rezultatet gjyqësore—mund të identifilohen modele dhe sfida të veçanta në secilin sistem. Kjo qasje jo vetëm që nxjerr në pah fushat ku SPAK-u mund të jetë motor i progresit në nivelet më të larta të ndjekjes penale, por gjithashtu evidenton boshllëqet apo nevojat për përmirësim brenda prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, duke siguruar që masat dhe burimet e synuara të shpërndahen në mënyrë të përshtatshme për të forcuar performancën kundër korrupsionit në të gjitha fushat.

(i) Të dhënat që duhet të mbliidhen

134. Numri i procedimeve penale të iniciuara për vepra penale të korrupsionit sipas nenit përkatës të Kodit Penal.
135. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për vepra penale të korrupsionit sipas nenit përkatës të Kodit Penal.
136. Numri i rasteve ku gjykata ka:
- a. urdhëruar përfundimin e hetimeve;



- b. vendosur të pranojë kërkesën e prokurorit dhe ta dërgojë çështjen në gjykim;
 - c. vendosur pushimin e akuzës ose të çështjes;
 - d. ndryshuar cilësimin e veprës penale;
 - e. shpallur të pafajshëm të pandehurin.
137. Të dhënat e kategorizuara sipas juridiksionit: SPAK dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm
138. Të dhëna mbi personat nën hetim dhe dërguar për gjykim për korrupsion, duke bërë dallimin midis rasteve të zyrtarëve të nivelit të lartë dhe rasteve të zyrtarëve të zakonshëm

(ii) **Vlerësimi**

139. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:
- a. Ka një rritje prej të paktën x% të numrit të procedimeve të reja penale për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës;
 - b. Ka një rritje të paktën x% të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për korrupsion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
 - c. Të paktën x% e procedimeve të dërguara për gjykim përfundojnë me një vendim fajësie;
 - d. Më pak se x% e procedimeve të dërguara për gjykim përfundojnë me vendim pushimi për mungesë provash ose shkelje procedurale;
 - e. Ka të paktën një rritje të dukshme të çështjeve të zyrtarëve të nivelit të lartë të hetuar ose të dërguar për gjykim në krahasim me vitin paraardhës.
140. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:
- a. Ka një rritje midis x% dhe x% të numrit të procedimeve të reja penale për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës;




- b. Ka një rritje midis x% dhe x% të numrit të procedimeve penale të dërguara për gjykim për korrupsion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
- c. Midis x% dhe x% të procedimeve penale të dërguara për gjykim përfundojnë me një vendim fajësie;
- d. midis x% dhe x% të procedurave të dërguara për gjykim përfundojnë me vendim pushimi për mungesë provash ose shkelje procedurale;
- e. Ka të paktën një rritje të dukshme të çështjeve të zyrtarëve të nivelit të lartë të hetuar ose të dërguar për gjykim në krahasim me vitin paraardhës.

141. Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Ka rënie ose mungesë rritje të numrit të procedimeve të reja penale për korrupsion krahasuar me vitin paraardhës;
- b. Ka një ulje ose mungesë të rritjes së numrit të procedimeve penale të dërguara për gjykim për korrupsion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
- c. Më pak se x% e procedurave penale të dërguara për gjykim përfundojnë me një vendim fajësie;
- d. Mbi x% e procedimeve penale të dërguara për gjykim përfundojnë me vendim pushimi për mungesë provash ose shkelje procedurale;
- e. Nuk ka raste të reja ose shumë pak raste të reja që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë në ndjekje penale.

(j) **Rritja e numrit të hetimeve pasurore**

142. Rritja e numrit të hetimeve pasurore për vepra penale që krijojnë të ardhura ose pasuri, duke nisur hetimin pasuror që në momentin e regjistrimit të procedimit penal dhe duke rritur kërkesat për masa të sigurimit pasuror, duke përfshirë ato që janë përdorur ose janë në pronësi të personave të



tretë. Rekomandohet të rritet numri i rasteve të konfiskimit përfundimtar të aseteve kriminale, që rrjedhin nga veprat penale të lidhura me korrupsionin.

143. Zgjerimi i fushës dhe rritja e shpeshtësisë së hetimeve pasurore për veprat penale që gjenerojnë të ardhura apo pasuri të paligjshme është thelbësor për forcimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e burimeve publike. Duke nisur hetimet pasurore sa më shpejt të jetë e mundur, idealisht që në momentin e regjistrimit të procedimit penal, autoritetet mund të ndjekin më efektivisht gjurmët e pasurisë, ta bllokojnë dhe, në fund, ta konfiskojnë atë që buron nga veprimtari korruptive apo kriminale. Kjo qasje proaktive shërben jo vetëm si një mjet frenues për shkelësit e mundshëm, por gjithashtu siguron që përfitimet e paligjshme t'i rikthehen shtetit dhe të ri-orientohen në shërbim të interesit publik. Në planin afatgjatë, masa të tilla forcojnë integritetin e institucioneve publike, reduktojnë humbjet financiare të shkaktuara nga korrupsioni dhe rrisin besimin e qytetarëve në aftësinë e sistemit të drejtësisë për të luftuar krimin ekonomik.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

144. Numri i hetimeve pasurore të nisura për vepra penale që krijojnë të ardhura ose pasuri, të ndara sipas:
- a. Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK.
 - b. Kategorive të veprave penale, si ato që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, veprat penale në fushën e tatimeve, etj.
 - c. Zyrtarëve të niveleve të ndryshme sipas kompetencës lëndore të parashikuar nga neni 75/a i K.Pr.Penale.
145. Numri i kërkesave për masa të sigurisë së pronës, të ndara sipas:
- a. Llojit të pasurisë: pasuri të paluajtshme, pasuri financiare, pasuri të tjera.
 - b. Persona të dyshuar për korrupsion dhe personat e lidhur (përfshirë ata që kanë pasuri në emër të paligjshëm të palëve të treta).



c. Sa nga këto kërkesa janë miratuar nga gjykata dhe sa prej tyre janë rrëzuar.

146. Numri i rasteve të konfiskimit të aseteve kriminale:

a. Pasuritë e konfiskuara që rrjedhin nga veprat penale të korrupsionit.

b. Të dhëna për çështjet ku është kërkuar konfiskimi i pasurive të palëve të treta.

c. Në sa raste nuk janë pranuar kërkesat e prokurorit për konfiskimin e pasurisë nga gjykata.

d. Vlera totale e pasurive të sekuestruara/konfiskuara për korrupsion dhe të lidhura me të.

e. Përqindja e pasurive të konfiskuara përfundimisht që kanë kaluar në favor të buxhetit të shtetit.

(ii) **Vlerësimi** [illegible]

147. Rekomandimi konsiderohet i **përmbushur** kur:

a. Ka një rritje prej të paktën $x\%$ në numrin e hetimeve pasurore të nisura krahasuar me vitin e kaluar;

b. Ka një rritje prej të paktën $x\%$ në numrin e kërkesave për masa të sigurimit pasuror krahasuar me vitin e kaluar;

c. Ka një rritje prej të paktën $x\%$ në numrin e rasteve të konfiskimit të pasurive të lidhura me korrupsionin;

d. Ka një rritje prej të paktën $x\%$ në konfiskimin e aseteve të palëve të treta që kanë përfituar në mënyrë të paligjshme;

e. Vlera e pasurive të konfiskuara është më e madhe se x milionë euro.

148. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:




- a. Ka një rritje midis $x\%$ dhe $x\%$ në numrin e hetimeve pasurore të nisura krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Ka një rritje midis $x\%$ dhe $x\%$ në numrin e kërkesave për masa të sigurimit pasuror krahasuar me vitin e kaluar;
- c. Ka një rritje midis $x\%$ dhe $x\%$ në numrin e rasteve të konfiskimit të pasurive të lidhura me korrupsionin;
- d. Ka një rritje midis $x\%$ dhe $x\%$ në konfiskimin e aseteve të palëve të treta që kanë përfituar në mënyrë të paligjshme;
- e. Vlera e pasurive të konfiskuara është midis x dhe x milionë euro.

149. Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Ka rënie ose mungesë të rritjes së numrit të hetimeve pasurore të nisura krahasuar me vitin paraardhës;
- b. Ka rënie ose mungesë të rritjes së numrit të kërkesave për masa të sigurimit pasuror krahasuar me vitin e kaluar;
- c. Ka rënie ose mungesë të rritjes së numrit të rasteve të konfiskimit të pasurive të lidhura me korrupsionin,
- d. Ka rënie ose mungesë të rritjes së konfiskimit të aseteve të palëve të treta që kanë përfituar në mënyrë të paligjshme;
- e. Ka rënie ose mungesë të rritjes së vlerës së pasurive të konfiskuara.

(k) **Veprat penale kibernetike**



150. T'i kushtohet vëmendje e veçantë krimeve kibernetike. Rekomandohet krijimi i seksioneve të specializuara brenda prokurorisë për luftën kundër krimit kibernetik, duke përdorur teknologji të avancuara.
151. Prokuroria përbëhet nga disa seksione të specializuara që trajtojnë kategori të ndryshme të aktivitetit kriminal. Duke shpërndarë ekspertizën dhe burimet në këto njësi të veçanta, prokuroria arrin të rrisë efektivitetin e punës së saj, veçanërisht në fusha të ndërlikuara dhe në zhvillim si krimi kibernetik. Kjo qasje strukturore mundëson menaxhim të mirë të çështjeve, krijimin e ekspertizës tematike brenda secilës njësi dhe mbështet zbatimin e strategjive të synuara për hetimin dhe ndjekjen penale të llojeve specifike të krimeve.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

152. Numri i procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e krimeve kibernetike, dhe përqindja e tyre në raport me numrin total të procedimeve të regjistruara.
153. Numri i procedimeve penale për këtë kategori, të ndara sipas llojit të veprës penale kibernetike.
154. Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim për krime kibernetike dhe përqindja e tyre në raport me numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të dërguara për gjykim.
155. Nëse ka Seksione të Specializuara për Krimin Kibernetik të ngritura brenda strukturës së prokurorisë, sipas juridiksionit, data e krijimit të njësive dhe numri i personelit në to.
156. Numri i rasteve kur janë përdorur teknika speciale hetimi, përgjime, vëzhgime, infiltrim, veprime proaktive etj në hetimin e krimeve kibernetike.

(ii) Vlerësimi

157. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur kur:**
- a. Ka një rritje prej të paktën x% në numrin e procedimeve penale për krime kibernetike krahasuar me vitin parardhës;



b. Është ngritur të paktën një njësi e specializuar për krimin kibernetik në Prokurorinë e Përgjithshme ose në të paktën një prokurori të juridiksionit të përgjithshëm;

c. Janë përdorur teknika speciale hetimi në më shumë se x% të hetimeve për në çështje konkrete të krimit kibernetike

158. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur kur:**

a. Ka një rritje midis x% dhe x% në numrin e procedimeve penale për krime kibernetike krahasuar me vitin paraardhës;

b. Është ngritur vetëm një njësi në fazë eksperimentale ose në bashkëpunim me njësi ekzistuese të policisë;

c. teknikat speciale të hetimit janë përdorur midis x% dhe x% të rasteve gjatë hetimit të krimit kibernetik.

159. Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur kur:**


a. Nuk ka rritje apo rënie të ndjeshme të numrit të procedimeve penale për krime kibernetike;

b. Nuk është ngritur asnjë njësi e specializuar në prokurori për luftën ndaj krimit kibernetik;

c. Nuk rezulton përdorimi i teknikave speciale të hetimit në hetimin e krimeve kibernetike.

(l) Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me BE-në

160. Rekomandohet forcimi i luftës kundër krimit të organizuar përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të tjera, si dhe ndëshkimi brenda vendit me masa të efektshme, me qëllim reduktimin e tij.



161. Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë është thelbësor për rritjen e efektivitetit të forcave të rendit dhe për adresimin e veprimtarive kriminale transnacionale. Ky bashkëpunim mundëson shkëmbimin e informacionit, burimeve dhe praktikave më të mira, duke rritur kapacitetin për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht çështje komplekse që kapërcejnë kufijtë kombëtarë. Nëpërmjet zbatimit të strategjive të forta dhe të koordinuara, si dhe të masave ndëshkuese efektive, vendet mund të godasin në mënyrë të ndjeshme rrjetet e krimit të organizuar, të parandalojnë shkelje të ardhshme dhe të promovojnë një nivel më të lartë sigurie si në planin kombëtar ashtu edhe në rajonin evropian.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen nga Prokuroria e Posaçme**

162. Numri i procedimeve penale të regjistruara që lidhen me krimin e organizuar, sipas neneve përkatëse të Kodit Penal, i ndarë sipas numrit të përgjithshëm të procedimeve, numrit të rasteve të referuara nga partnerët ndërkombëtarë, si dhe numrit të procedimeve të përbashkëta ose të koordinuara me vendet e tjera.

163. Numri i marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtar të nënshkruara ose të zbatuara gjatë vitit, të lidhura me shtetet anëtare të BE-së, shtetet e tjera joanëtare; agjencitë ndërkombëtare.

164. Numri i kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare, duke përfshirë si ato të dërguara, ashtu edhe ato të pranuar nga autoritetet e huaja, nëpërmjet autoritetit qendror - Ministrisë së Drejtësisë.

165. Numri i operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare të zhvilluara në fushën e krimit të organizuar, duke përfshirë rastet e hetuara në bashkëpunim me autoritetet e vendeve të BE-së apo me vendet e tjera, si dhe numri i të ndjekurve/arrestuarve në këto operacione.

166. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për veprat penale në fushën e krimit të organizuar si dhe rezultatet përkatëse, përfshirë vendimet për dënimet përfundimtare, dënimet alternative, shpalljet e pafajësisë dhe vendimet për pushim të çështjes.



167. Masat e marra për ndëshkimin efektiv të autorëve të veprave penale, duke përfshirë numrin e konfiskimeve të pasurive në kuadër të hetimeve për krimin e organizuar, si dhe garantimin e masave të sigurimit pasuror të vendosura gjatë hetimeve.


(ii) **Vlerësimi**

168.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur plotësisht** kur:

- a. Numri i procedimeve penale në lidhje me krimin e organizuar është rritur me të paktën $x\%$ përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me vendet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera, krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Të paktën x operacione të përbashkëta ndërkombëtare janë kryer gjatë vitit në bashkëpunim me agjencitë e BE-së ose me vendet e tjera;
- c. x marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara ose të zbatuara të cilat kanë sjellë rezultate konkrete në hetimin dhe ndjekjen penale;
- d. Në kuadër të këtyre hetimeve janë shtuar masat ndëshkuese efektive, të cilat kanë çuar në rritje të numrit të dënimeve dhe të vendimeve për konfiskimin e pasurive;
- e. Përdorimi i metodave speciale të hetimit është rritur ndjeshëm, duke arritur të zbatohet në më shumë se $x\%$ të rasteve që lidhen me krimin e organizuar.

169.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur pjesërisht** kur:

- a. Numri i procedimeve penale që lidhen me krimin e organizuar, përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me vendet anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera, është rritur midis $x\%$ - $x\%$ krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Janë kryer të paktën midis x dhe x operacione të përbashkëta ndërkombëtare gjatë vitit, në bashkëpunim me agjencitë e BE-së ose me vendet e tjera;




- c. Marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar ose zbatuar midis x dhe y, të cilat kanë sjellë rezultate konkrete në hetimin dhe ndjekjen penale;
- d. Masat ndëshkuese efektive janë rritur në mënyrë të moderuar në kuadër të këtyre hetimeve, duke sjellë një rritje të numrit të dënimeve dhe vendimeve që lidhen me konfiskimin e pasurive;
- e. Përdorimi i metodave speciale hetimore është rritur në mënyrë të moderuar, duke u aplikuar në një përqindje midis x% - x% të rasteve të krimit të organizuar.

170.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Numri i procedimeve penale për krimin e organizuar, përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe me vendet e tjera, ka shënuar një rënie ose nuk ka pasur rritje krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Ka pasur një ulje ose nuk është shënuar rritje në numrin e operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare gjatë vitit, të kryera me agjencitë e BE-së ose me vendet e tjera;
- c. Ka një ulje ose nuk është shënuar rritje në numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ose të zbatuara në hetimin dhe ndjekjen penale;
- d. Ka një ulje ose nuk është shënuar rritje në përdorimin e masave ndëshkuese efektive, brenda këtyre hetimeve;
- e. Ka një ulje ose nuk është shënuar rritje në përdorimin e metodave speciale të hetimit.

(m) Rritja e rasteve të trafikimit të lëndëve narkotike

171.Të rriten rastet e procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike, duke diferencuar veprat penale që lidhen me sasi minimale të narkotikëve dhe duke ndërmarrë qëndrime të ashpra, brenda kompetencave të prokurorisë, për caktimin e masave të sigurimit personal dhe kërkimin e dënimeve për rastet e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.



(i) **Të dhënat që duhet të mbliidhen**

172. Numri i procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike, sipas neneve përkatëse të Kodit Penal të ndara sipas: veprave penale të parashikuara në Kod, përveç rastit të përdorimit vetjak.

173. Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim për secilën nga kategoritë e mësipërme të ndarë sipas: dënimit për përdorim vetjak (me një sasi minimale) dhe rasteve të tjera.

174. Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim në raport me numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara.

175. Të dhëna mbi masat e sigurimit personal, llojin dhe shkallën e dënimit të kërkuar nga prokuroria dhe të vendosur nga gjykata, për këtë grup veprash penale.

(ii) **Vlerësimi**

176. Rekomandimi konsiderohet **i përmbushur plotësisht** kur:

- a. Ka një rritje prej të paktën x% të numrit të procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Janë dërguar për gjykim të paktën x% e procedimeve penale të regjistruara për trafikim dhe kultivim;
- c. Për veprat penale të rënda (trafikim, kultivim) janë kërkuar dhe caktuar masa sigurimi personal të rënda (arrest me burg ose arrest shtëpie) në më shumë se x% të rasteve;
- d. Ka një shkallë të lartë të dënimeve me burgim për këto vepra penale, krahasuar me vitin e kaluar;
- e. Ka diferencim të qartë dhe të dokumentuar mes veprave që lidhen me sasi minimale dhe atyre me rrezikshmëri të lartë.



177.Rekomandimi konsiderohet **i përmbushur pjesërisht** kur:

- a. Ka një rritje midis x% dhe x% të numrit të procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike krahasuar me vitin e kaluar;

Janë dërguar për gjykim midis x% dhe x% të procedimeve penale të regjistruara për trafikim dhe kultivim;

- b. Për veprat penale të rënda (trafikim, kultivim), janë kërkuar dhe caktuar masa sigurimi personal të rënda (arrest me burg ose arrest shtëpi) për midis x% dhe x% të rasteve;
- c. Ka një shkallë mesatare dënimesh me burgim për këto vepra penale, krahasuar me vitin e kaluar;
- d. Diferencimi ndërmjet veprave për sasi të vogla dhe atyre më të rënda nuk është sistematik, por është dokumentuar në disa raste.

178.Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. Nuk ka rritje apo ulje të numrit të procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Nuk ka rritje apo ulje të numrit të procedimeve penale të dërguara për gjykim për trafikim dhe kultivim;
- c. Nuk ka rritje apo ulje të numrit të procedimeve penale kur janë kërkuar dhe caktuar masa sigurimi personal të rënda (arrest në burg ose arrest shtëpie) për vepra penale të rënda (trafikim, kultivim);
- d. Ka një shkallë të ulët të dënimeve me burgim për këto vepra penale, krahasuar me vitin e kaluar;
- e. Nuk ka diferencim të dokumentuar ndërmjet veprave që lidhen me përdorimin vetjak dhe atyre që lidhen me veprimtari kriminale të strukturuar.

(n) Rritja e numrit të veprave penale në fushën e trafikimit



179. Rritja e numrit të procedimeve penale për vepra në fushën e trafikimit, përfshirë trafikimin e të miturve, si kategori vulnerabël. Gjithashtu, SPAK-u duhet të vazhdojë të rrisë numrin e procedimeve penale për çështjet e krimit të organizuar dhe ashpërsimit të politikës penale për këto vepra.

180. Ky seksion është thelbësor pasi përcakton kritere konkrete për matjen e progresit në luftën kundër trafikimit dhe krimeve të rënda lidhur me të. Përmes specifikimit të standardeve cilësore dhe sasiore, si rritja e procedimeve penale, diferencimi i llojeve të veprave penale dhe përmirësimi i metodave të mbledhjes së të dhënave, ky seksion ofron një kuadër për llogaridhënie dhe përmirësim të synuar. Kjo qasje siguron që autoritetet jo vetëm të ndjekin tendencat, por edhe të përmirësojnë në mënyrë proaktive reagimin e tyre ndaj aktiviteteve kriminale, veçanërisht ato që prekin kategoritë vulnerabël si të miturit. Vendorsja e objektivave të qarta ndihmon në identifikimin e fushave ku politikat dhe zbatimi duhet të përshtaten, duke forcuar efektivitetin e ndërhyrjeve kundër trafikimit dhe krimit të organizuar.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:


181. Numri i procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e trafikimit, të ndara sipas kategorive: trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i të miturve, trafikimi i organeve, trafikimi me qëllime shfrytëzimi seksual, puna e detyruar etj.

182. Numri i hetimeve të regjistruara dhe të përfunduara nga SPAK për veprat penale të krimit të organizuar që lidhen me trafikimin dhe strukturat kriminale që përfshijnë trafikimin ndërkombëtar apo rrjetet kriminale të organizuara.

183. Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim, për të gjitha kategoritë e mësipërme dhe numri i kërkesave për dënime me burgim; vendimet për pushimin e akuzës ose çështjes, vendimet për konfiskimin e pasurive të lidhura me trafikimin apo organizatat kriminale.

184. Të dhëna krahasuese me vitet e mëparshme në lidhje me numrin e procedimeve të reja penale për trafikime, numrin e procedimeve penale të regjistruara nga SPAK-u për krimin e organizuar të lidhur me trafikimin, evoluimin e dënimeve dhe përdorimin e politikës penale represive.

(ii) Vlerësimi



185.Rekomandimi konsiderohet i **përbashur plotësisht** kur:


- a. Ka një rritje prej të paktën x% në numrin e procedimeve penale për veprat penale të trafikimit krahasuar me vitin e kaluar, të ndara sipas kategorive të mësipërme;
- b. Ka një rritje prej të paktën x% në numrin e procedimeve penale të trafikimit të të miturve të dërguar për gjykim;
- c. SPAK ka regjistruar një rritje të numrit të procedimeve penale për krim të organizuar të lidhur me trafikimin prej të paktën x%;
- d. Të paktën x% e procedimeve penale përfundojnë me dënim me burgim për krime të trafikimit.

186.Rekomandimi konsiderohet i **përbashur pjesërisht** kur:

- a. Ka një rritje midis x% dhe x% në numrin e procedimeve penale për vepra penale të trafikimit krahasuar me vitin e kaluar, të ndara sipas kategorive të mësipërme;
- b. Ka një rritje midis x% dhe x% në numrin e procedimeve të trafikimit të të miturve të dërguar për gjykim;
- c. SPAK ka regjistruar rritje të numrit të procedimeve penale për krim të organizuar të lidhur me trafikimin midis x% dhe x%;
- d. midis x% dhe x% të procedimeve penale përfundojnë me dënim me burgim për krime trafikimi.

187.Rekomandimi konsiderohet i **papërbashur** kur:

- a. Ka një rënie ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale për veprat penale të trafikimit krahasuar me një vit më parë, të ndara sipas kategorive të mësipërme;
- b. Ka një rënie ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale për trafikimin e të miturve të dërguar për gjykim;



- c. Ka një rënie ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale të regjistruara nga SPAK për krimin e organizuar të lidhur me trafikimin;
- d. Ka një rënie ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale që përfundojnë me dënim me burgim për krime trafikimi.

(o) Rritja e numrit të rasteve lidhur me format e reja të krimeve, duke përfshirë krimin kibernetik

188. Shtimi i vigjilencës dhe rritja e numrit të procedimeve penale për format e reja të krimeve të kryera nga krimi i organizuar, si: mashtrimi kompjuterik në formë të organizuar (call center-at), ndërhyrja e paautorizuar në sistemet e institucioneve publike dhe bankave, falsifikimi kompjuterik i të dhënave personale dhe financiare, mashtrimi kompjuterik nëpërmjet kriptovalutatave dhe pastrimi i parave me to, skemat e mashtrimit si “*phishing*”, *ransomware* etj., trafikimi i qenieve njerëzore në forma të reja, përdorimi i rrjeteve sociale për shitjen e armëve, drogës., krimi mjedisor i organizuar, manipulimi i tregjeve financiare, etj.


(i) Të dhënat që duhet të mbledhen:

189. Numri i procedimeve penale të regjistruara për secilën nga format të listuara të krimit të organizuar në këtë rekomandim, duke përfshirë:

- a. Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim për këto vepra penale.
- b. Numri i procedimeve penale të regjistruara nga SPAK në këto fusha, veçanërisht për rastet me përfshirje ndërkombëtare ose me ndikim të gjerë ekonomik/social.
- c. Të dhëna krahasuese me vitet e mëparshme, për të evidentuar trendin e përpjekjeve për hetimin e formave të reja të aktiviteteve kriminale.

(ii) Vlerësimi

190. Rekomandimi konsiderohet i përmbyllur plotësisht kur:



- a. Ka një rritje prej të paktën x% të numrit të procedimeve penale të reja për format e reja të krimit të organizuar krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Të paktën x% e procedimeve penale të regjistruara janë dërguar për gjykim dhe pjesa më e madhe përfundon me vendim fajësie;
- c. Janë identifikuar dhe ndjekur penalisht të paktën x ose më shumë forma të listuara në rekomandim;
- d. SPAK ka shqyrtuar të paktën x procedime penale në vit që përfshijnë krime të organizuara në këto fusha.

191.Rekomandimi konsiderohet **i përmbushur pjesërisht** kur:

- a. Ka një rritje midis x% dhe x% të numrit të procedimeve penale të reja për forma të reja të krimit të organizuar, krahasuar me një vit më parë;
- b. Ka një rritje midis x% dhe x% të procedimeve penale të regjistruara të cilat janë dërguar për gjykim dhe pjesa më e madhe përfundon me një vendim fajësie;
- c. Janë identifikuar dhe ndjekur penalisht midis x dhe x forma të listuara në rekomandim;
- d. SPAK ka shqyrtuar të paktën nga x deri në x çështje në vit që përfshijnë krime të organizuara në këto fusha.

192.Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. Ka ulje ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale të reja për format e reja të krimit të organizuar krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Ka ulje ose mungesë rritje në numrin e procedimeve penale të regjistruara të dërguara për gjykim;
- c. Janë identifikuar dhe ndjekur penalisht më pak se x forma të listuara në rekomandim;



- d. SPAK ka shqyrtuar të paktën më pak se x procedime penale në vit që përfshijnë krime të organizuara në këto fusha.

(p) Rritja e vigjilencës së veprave penale të lidhura me terrorizmin

193. Rritja e vigjilencës për veprat e mundshme penale në fushën e terrorizmit, duke mbajtur në konsideratë situatën globale dhe duke bashkëpunuar me institucionet që veprojnë në këtë fushë.

194. Rëndësia e vigjilencës së shtuar në luftën kunder veprave penale të lidhura me terrorizmin nuk mund të nënvlerësohet. Në kontekstin e një sigurie globale në ndryshim të vazhdueshëm, kërcënimi nga terrorizmi mbetet prezent dhe dinamik, si dhe identifikimi, hetimi dhe ndjekja penale e menjëhershme e veprave të tilla janë thelbësore për ruajtjen e sigurisë publike dhe ruajtjen e shtetit të së drejtës. Matja e efektivitetit të vigjilencës së shtuar përfshin gjurmimin e treguesve kryesorë si numri i procedimeve të reja penale të iniciuara, përqindja e çështjeve të referuara për gjykim, shkalla e dënimeve dhe shkalla e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Duke mbledhur dhe analizuar sistematikisht këto të dhëna, autoritetet mund të vlerësojnë progresin, të identifikojnë boshllëqet dhe të sigurojnë që burimet të përdoren në mënyrë efektive për të adresuar kërcënimet e mëtejshme.


(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

195. Numri i procedimeve penale të regjistruara për vepra penale në fushën e terrorizmit.

196. Numri i procedimeve penale të nisura dhe të përfunduara për këto vepra, si dhe rezultatet e tyre (derfimi për gjykim, pushim, vendime fajësie ose pafajësie).

197. Numri i procedimeve penale të regjistruara nga SPAK në fushën e terrorizmit dhe bashkëpunimit të tij me institucione të tjera (shërbimet e inteligjencës, antiterrori në policinë e shtetit, INTERPOL, EUROPOL etj.).

198. Numri i rasteve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke përfshirë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, hetime të përbashkëta me agjenci të tjera, pjesëmarrje në task-forca ose struktura të përbashkëta.



(ii) **Vlerësimi**

199.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur plotësisht** kur:

- a. Është identifikuar një rritje ose qëndrueshmëri e angazhimit në hetimin e çështjeve të terrorizmit (të paktën x procedura të reja në vit);
- b. Të paktën x% e procedimeve të regjistruara dërgohen për gjykim, me një shkallë të lartë të vendimeve të dënimit;
- c. SPAK ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në të paktën x raste;
- d. Janë ndërmarrë masa parandaluese në përputhje me situatën globale të sigurisë (p.sh. sekuestrime, masa sigurie, ndalime, kontrolli i financimeve);

200.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur pjesërisht** kur:

- a. Është identifikuar angazhimi në hetimin e rasteve të terrorizmit (të paktën x procedura të reja në vit);
- b. Midis x% dhe x% të procedurave të regjistruara dërgohen për gjykim;
- c. SPAK ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në të paktën x raste;
- d. Janë ndërmarrë masa parandaluese në mënyrë sporadike, jo sistematike; (p.sh. sekuestrime, masat e sigurisë, ndalimet, kontrolli i financimeve).

201.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Nuk është regjistruar asnjë procedim i ri penal në fushën e terrorizmit;
- b. Nuk ka çështje të dërguara për gjykim ose ka vetëm pushime pa argumentim të mjaftueshëm;



- c. Nuk ka bashkëpunim të dokumentuar me institucione të tjera vendase ose ndërkombëtare;
- d. Nuk janë ndërmarrë masa parandaluese, edhe pse ka indikacione për rrezik.

(q) Rritja e numrit të hetimeve pasurore për veprat penale të pastrimit të parave dhe të produkteve të krimit

202. Të rriten rastet e hetimeve pasurore për veprat penale të pastrimit të parave dhe të produkteve të veprës penale, numrin e procedimeve pasurore, procedimet penale, numrin e të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe numri i sekuestrimeve /konfiskimeve, rekomandimet e përsëritura, të cilat kërkojnë vëmendje të veçantë dhe njohjen dhe zhvillimin e kapaciteteve në lidhje me format e reja të këtyre veprave penale. Rekomandohet të përmirësohen teknikat e hetimit të prokurorisë, si hetimi i krimit financiar, si dhe të përmirësohen sistemet e analizës penale dhe metodologjive për zgjidhjen e çështjeve komplekse penale. Të rritet përdorimi i masave të posaçme hetimore për të siguruar konsistencën midis sekuestrimit paraprak të pasurisë dhe konfiskimeve.

203. Rëndësia e rritjes së rasteve të hetimeve pasurore për veprat penale të pastrimit të parave dhe të produkteve të krimit nuk mund të nënvlerësohet, pasi këto përpjekje janë të domosdoshme për të goditur strukturat kriminale, për të rritur integritetin e sistemit financiar dhe për të parandaluar krimet në të ardhmen. Hetimet efektive të pasurisë jo vetëm që ndihmojnë në gjurmimin e pasurive të paligjshme, por gjithashtu forcojnë shtetin e së drejtës duke siguruar që të ardhurat nga krimi të identifikohen, sekuestrohen dhe konfiskohen. Për të vlerësuar sa efektive janë këto përpjekje, nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse që kombinon tregues sasiore dhe cilësore. Treguesit kryesorë përfshijnë numrin e procedimeve pasurore dhe penale të iniciuara dhe të dërguara për gjykim, frekuencën dhe vlerën e sekuestrimit dhe masave të sigurisë të vendosura, përdorimin e masave të veçanta hetimore dhe krijimin ose përmirësimin e strukturave të specializuara hetimore. Për më tepër, monitorimi i pjesëmarrjes së personelit në trajnimet dhe aktivitetet përkatëse jep informacion mbi përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve. Të gjitha këto të dhëna ndihmojnë për të krijuar një pamje të qartë të progresit dhe për të identifikuar fushat ku kërkohet përmirësim ose investim i mëtejshëm në burime.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:




204. Numri i referimeve pasurore të regjistruara sipas ligjit Antimafia, krahasuar me vitin e kaluar.
205. Numri i procedimeve penale të regjistruara për pastrim parash dhe produkteve të veprave penale, krahasuar me një vit më parë.
206. Numri i referimeve pasurore/procedimeve penale të dërguara për gjykim për veprën penale të pastrimit të parave dhe produktit të veprës penale.
207. Numri i personave të pandehur të dërguar për gjykim për këto vepra penale.
208. Numri dhe vlera e masave të sigurimit pasuror gjatë hetimeve për këto vepra penale.
209. Numri dhe vlera e sekuestimeve të pasurive, si dhe raporti midis pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
210. Numri i procedimeve pasurore/penale në të cilat janë përdorur teknika të posaçme hetimore.
211. Ngritja ose forcimi i strukturave të specializuara për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar (njësi të reja, staf i trajnuar, mjete teknike).
212. Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që lidhen me hetimin e pastrimit të parave dhe analizën pasurore.

(ii) Vlerësimi

213. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Ka rritje prej të paktën x% në numrin e procedimeve pasurore/penale për pastrimin e parave dhe produkte të vepres penale, krahasuar me vitin e kaluar.
- b. Ka rritje prej të paktën x% në numrin e procedimeve dhe të të pandehurve të dërguar për gjykim.
- c. Ka rritje prej të paktën x% në numrin e masave të sigurimit pasuror dhe konfiskimit, me konsistencë ndërmjet tyre.




- d. Ka rritje prej të paktën x% në numrin të masave të posaçme hetimore të hetimeve përkatëse.
- e. Ka një rritje prej të paktën x% në aplikimin e analizave pasurore dhe financiare në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve komplekse.
- f. Është realizuar forcimi i kapaciteteve hetimore përmes trajnimeve, metodologjive të reja ose mjeteve të avancuara teknologjike.

214.Rekomandimi konsiderohet i **përmbushur pjesërisht** kur:

- a. Ka rritje midis x% dhe x% të numrit të procedimeve pasurore/penale për pastrimin e parave dhe të produkteve të veprave penale, krahasuar me një vit më parë.
- b. Ka rritje midis x% dhe x% në numrin e procedimeve pasurore/penale dhe të të pandehurve të dërguar për gjykim.
- c. Ka rritje midis x% dhe x% në numrin e masave të sigurimit pasuror dhe konfiskimit, me konsistencë ndërmjet tyre.
- d. Ka rritje midis x% dhe x% në numrin e masave të posaçme hetimore të hetimeve përkatëse.
- e. Ka midis x% dhe x% në aplikimin e analizave pasurore dhe financiare në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve komplekse.
- f. Përmirësimi i kapaciteteve është pjesërisht i dokumentuar (p.sh. vetëm trajnim teorik, pa mjete të reja apo pa njësi të specializuara).

215.Rekomandimi konsiderohet i **papërmbushur** kur:

- a. Ka ulje ose nuk ka rritje në numrin e procedimeve pasurore/penaleve për pastrimin e parave dhe produkteve të veprës penale, krahasuar me vitin e kaluar.
- b. Ka ulje ose nuk ka rritje në numrin e procedimeve pasurore/penale dhe të të pandehurve të dërguar për gjykim.



- c. Ka një ulje ose nuk ka rritje të numrit të masave të sigurimit pasuror dhe konfiskimit, me konsistencë ndërmjet tyre.
 - d. Ka ulje ose nuk ka rritje të numrit të masave të posaçme hetimore të hetimeve përkatëse.
 - e. Ka rënie ose nuk ka rritje të aplikimit të analizave pasurore dhe financiare në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve komplekse.
 - f. Nuk ka asnjë tregues të përmirësimit të kapaciteteve, qoftë në personel, teknika apo analiza.
- (r) Të shtohet vëmendja në lidhje me masat e sigurimit personal dhe llojin e masave të dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve dhe grave.**

216. Rritja e vëmendjes ndaj masave të sigurimit personal, si dhe përmirësimi i llojeve dhe ashpërsisë së dënimit për vepra me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, është e një rëndësie të madhe në nxitjen e një shoqërie të drejtë dhe të mbrojtur. Këto krime, veçanërisht ato që përfshijnë keqtrajtimin, abuzimin, shfrytëzimin dhe trafikimin e fëmijëve dhe grave, shkaktojnë pasoja të rënda dhe afatgjata si për individët ashtu dhe komunitetin. Në mungesë të masave të forta të sigurisë dhe ndëshkimeve të përshtatura me seriozitetin e veprave, grupet vulnerabël mbeten të ekspozuara ndaj cikleve të dhunës dhe shfrytëzimit, duke dobësuar besimin e qytetarëve në institucione dhe duke dëmtuar strukturën e drejtësisë sociale. Përmes prioritizimit të këtyre masave, shoqëria jo vetëm që mbështet viktimat dhe mbron të drejtat dhe dinjitetin e tyre, por edhe ndërton një sistem më të fortë parandalimi për veprat e ardhshme, promovon llogaridhënien dhe të siguron që drejtësia të jetë jo thjesht teorike, por e zbatuar në mënyrë kuptimplotë në jetën e atyre që janë më të rrezikuar.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

217. Numri i procedimeve penale të regjistruara për kategoritë e veprave penale me natyrë gjinore, me natyrë seksuale, veprat penale të abuzimit/shfrytëzimit/keqtrajtimit të fëmijëve dhe grave, trafikimit të fëmijëve dhe grave.



218.Numri dhe llojet e masave të sigurimit personal të kërkuara në këto çështje.

219.Numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim, për secilën nga kategoritë e lartpërmendura.

220.Rastet kur janë kërkuar ose vendosur masa mbrojtëse për viktimat (veçanërisht fëmijët dhe gratë).

221.Marrja e masave të posaçme për hetimin dhe mbrojtjen e viktimave vulnerabil (prania e psikologëve, kujdestarit ligjor, ambiente të posaçme marrjeje në pyetje, mungesa e riviktimizimit gjatë procesit gjyqësorëtj.).

(ii) Vlerësimi

222.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur plotësisht** kur:

- a. Ka një rritje prej të paktën $x\%$ të procedimeve penale të regjistruara për veprat e lartpërmendura, krahasuar me një vit më parë.
- b. Janë marrë masa të duhura dhe efektive të sigurimit personal në mbi $x\%$ të rasteve, duke reflektuar natyrën e rëndë të veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit.
- c. Janë kërkuar dhe dhënë nga gjykata masa të mjaftueshme ndëshkuese, duke mos përdorur sistematikisht dënime të ulëta ose alternativa ndaj dënimit me burgim.
- d. Janë marrë masa mbrojtëse për viktimat në mbi $x\%$ të çështjeve
- e. Janë zbatuar protokolle të veçanta për trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, në mbi $x\%$ të çështjeve.

223.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur pjesërisht** kur:

- a. Ka rritje midis $x\%$ - $x\%$ të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale të lartpërmendura, krahasuar me një vit më parë.
- b. Janë marrë masa të duhura dhe efektive të sigurimit personal në $x\%$ - $x\%$ të rasteve, duke reflektuar natyrën e rëndë të veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit.



- c. Janë kërkuar dhe dhënë nga gjykata masa të njaftueshme ndëshkuese, duke përdorur dënime të ulëta ose alternativa ndaj dënimit me burgim.
- d. Janë marrë masa mbrojtëse për viktimat në x% - x% të çështjeve.
- e. Janë zbatuar protokolle të veçanta për trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit në x% - x% të çështjeve, ose zbatimi i tyre nuk është i njëtrajtshëm në të gjitha prokuroritë.

224.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Nuk ka rritje apo ulje të numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale të lartpërmendura, krahasuar me një vit më parë.
- b. Nuk janë marrë masa të përshtatshme dhe efektive të sigurimit personal në më shumë se x% të rasteve.
- c. Dënimet e kërkuara janë në nivelin minimal.
- d. Janë marrë masa mbrojtëse për viktimat në më pak se x% të rasteve
- e. Janë zbatuar protokolle të veçanta për trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit në më pak se x% të rasteve ose zbatimi i tyre nuk është i njëtrajtshëm në të gjitha prokuroritë.

(s) **Të shtohet vëmendja për dhunën në familje (veçanërisht ndaj grave)**

225.Rritja e vëmendjes për dhunën në familje, e cila është e drejtuar kryesisht ndaj grave, caktimi i masave të sigurimit personal dhe dënimin e autorëve të veprës penale, veçanërisht atyre që janë recidivistë, si dhe në rastet kur kjo vepër ka ndodhur në prezencë të të miturve.

226.Duke i dalluar këto vepra nga format e tjera të dhunës, ligjvënësit, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore mund të identifikojnë më saktë modelet, të caktojnë burimet dhe të zhvillojnë ndërhyrje të synuara që adresojnë natyrën e veçantë të dhunës me bazë gjinore. Kjo qasje njih ndikimin e pabarabartë



që krime të tilla kanë tek gratë dhe fëmijët, veçanërisht në rastet që përfshijnë autorë recidivistë apo situata ku të miturit janë dëshmitarë të dhunës. Mbledhja e saktë e të dhënave siguron që masat mbrojtëse të jenë të menjëhershme dhe efektive, ndjekja penale të jetë e qëndrueshme dhe dënimi të pasqyrojë seriozitetin e këtyre veprave penale. Si përfundim, izolimi i këtyre krimeve ndihmon në formulimin e kuadrove ligjore më të përgjegjshme dhe nxit një mjedis më të sigurt për gratë dhe grupet vulnerabël.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:

227. Numri i procedimeve penale të regjistruara për kategoritë e dhunës në familje, rasteve të dhunës se ushtruar në prani të fëmijëve dhe rasteve me recidivistë.

228. Numri i rasteve kur është kërkuar dhe vendosur masa sigurimi personal ndaj autorit (arrest me burg, arrest shtëpie, ndalimi i kontaktit me viktimën etj.).

229. Numri i kërkesave të prokurorisë për llojin e masës së sigurimit personal.

230. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim dhe vendimmarrja e gjykatës.

(ii) Vlerësimi

231. Rekomandimi konsiderohet i **përmbushur** kur:

- a. Ka rritje prej të paktën x% të rasteve të regjistruara për dhunë ndaj grave, duke përfshirë rastet në prani të fëmijëve dhe me autorë recidivistë;
- b. Masat të sigurimit personal janë kërkuar dhe vendosur në mbi x% të rasteve, në përputhje me rrezikshmërinë dhe historikun kriminal të autorit;
- c. Për autorët (veçanërisht recidivistë) janë kërkuar dhe vendosur masa të ashpra sigurie dhe ndëshkimi, duke shmangur masat e buta ose dënimet alternative, në mbi x% të rasteve;
- d. Në rastet kur dhuna ka ndodhur në prani të të miturve, janë marrë masa shtesë ndaj autorit dhe masa mbrojtëse për të miturit.



232.Rekomandimi konsiderohet i **përmbyshur** pjesërisht kur:

- a. Ka rritje midis $x\%$ - $x\%$ të rasteve të regjistruara për dhunë ndaj grave, përfshirë rastet në prani të fëmijëve dhe me autorë recidivistë;
- b. Masat e sigurimit personal janë kërkuar dhe vendosur në $x\%$ - $x\%$ të rasteve, në përputhje me rrezikshmërinë dhe historikun kriminal të autorit;
- c. Për autorët (veçanërisht recidivistë) janë kërkuar dhe vendosur masa të ashpra sigurie dhe ndëshkimi, duke shmangur masat e buta ose dënimet alternative, në $x\%$ - $x\%$ të rasteve;
- d. Janë ndjekur penalisht rastet e dhunës në prani të të miturve, por pa masa të veçanta procedurale ose pa ndëshkim më të rreptë.

233.Rekomandimi konsiderohet i **papërmbyshur** kur:

234.Ka rënie ose nuk ka rritje të numrit të çështjeve të regjistruara të dhunës ndaj grave, duke përfshirë rastet në prani të fëmijëve dhe me autorë recidivistë;


235.Masat e sigurimit personal janë kërkuar dhe vendosur në më pak se $x\%$ të rasteve,

236.Për autorët (veçanërisht recidivistë) janë kërkuar dhe vendosur masa të ashpra sigurie dhe ndëshkimi, duke shmangur masat e buta ose dënimet alternative, në më pak se $x\%$ të rasteve;

237.Rastet në prani të të miturve nuk trajtohen në mënyrë të diferencuar dhe nuk merren masa shtesë;

(t) **Të rritet fokusi ndaj veprave penale që lidhen me procesin zgjedhor", me qëllim hetimin e shpejtë dhe efikas të tyre.**

238.Ky rekomandim është veçanërisht i rëndësishëm, sepse ruajtja e integritetit të procesit zgjedhor është thelbësore për mbrojtjen e parimeve demokratike dhe besimit të publikut në qeverisje. Veprat që lidhen me procesin zgjedhor, të tilla si blerja e votës, frikësimi i votuesve dhe falsifikimi i dokumenteve, dëmtojnë themelin e demokracisë përfaqësuese. Zbatimi i ligjit në mënyrë të plotë ndaj këtyre veprave, përmes hetimeve të plota dhe ndjekjes penale efektive, jo vetëm që funksionon si një mekanizëm



parandalues ndaj sjelljes së paligjshme, por edhe afirmon legjitimitetin e rezultateve zgjedhore. Një qasje e fokusuar, e mbështetur nga mbledhja e saktë e të dhënave dhe masat hetimore të përshtatura, garanton mbrojtjen e të drejtës së votës dhe forcon bindjen se zgjedhjet zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe transparente.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:

239. Numri i procedimeve penale të regjistruara që lidhen me zgjedhjet gjatë vitit (ose gjatë një procesit zgjedhor), të ndara sipas veprave penale të parashikuara në nenet përkatëse të Kodit Penal (blerja e votës, kërcënim i votuesve, pengimi i ushtrimit të së drejtës së votës, falsifikimi i dokumenteve zgjedhore, etj.).

240. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim, për **vepra penale që lidhen me procesin zgjedhor**

241. Numri i të pandehurve për këto vepra dhe statusi i tyre (funksionarë publikë, persona politikë, qytetarë të thjeshtë).

242. Përqindja e numrit të këtyre veprave veprat penale të lidhura me zgjedhjet krahasuar me numrin total të procedimeve të regjistruara.

243. Numri i masave të sigurimit personal të kërkuara/të vendosura për këto vepra penale.

244. Numri i rasteve kur janë përdorur metoda të veçanta hetimore, si përgjime, vëzhgimi, etj.

(ii) Vlerësimi

245. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Ka rritje me x% të numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për vepra penale të lidhura me zgjedhjet, krahasuar me periudhat zgjedhore të mëparshme;
- b. Ka rritje me x% të numrit të të pandehurve për këto vepra dhe statusit të tyre (funksionarë publikë, persona politikë, qytetarë të thjeshtë).



- c. Ka një rritje me $x\%$ të numrit të çështjeve për të cilat gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurve për këto vepra penale.
- d. Prokuroria përdor metoda të posaçme hetimore dhe kërkon masa sigurie për të garantuar hetimin në mbi $x\%$ të rasteve;

246.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur** pjesërisht kur:

- a. Ka një rritje midis $x\%$ - $x\%$ në numrin e procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për vepra penale të lidhura me zgjedhjet, krahasuar me periudhat e mëparshme zgjedhore;
- b. Ka një rritje midis $x\%$ - $x\%$ në numrin e të pandehurve për këto vepra dhe statusit të tyre (funktionarë publikë, persona politikë, qytetarë të thjeshtë).
- c. Ka një rritje me $x\%$ të numrit të çështjeve për të cilat gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurve për këto vepra penale.
- d. Prokuroria përdor metoda të posaçme hetimore dhe kërkon masa sigurie për të garantuar hetimin midis $x\%$ - $x\%$ të rasteve.

247.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Ka një ulje ose nuk ka rritje të numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për vepra penale që lidhen me zgjedhjet, krahasuar me periudhat e mëparshme zgjedhore;
- b. Ka një rënie ose nuk ka rritje të numrit të të pandehurve për këto vepra dhe statusit të tyre (funktionarë publikë, persona politikë, qytetarë).
- c. Ka ulje ose nuk ka një rritje të numrit të çështjeve për të cilat gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurve për këto vepra penale.;
- d. Prokuroria përdor metoda të posaçme hetimore dhe kërkon masa sigurie për të garantuar hetimin në më pak se $x\%$ të rasteve.




(u) Rritja e numrit të procedimeve penale që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve

248. Rekomandohet rritja e numrit të procedimeve penale për vepra që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve, me fokus të veçantë ndaj shkeljeve në fushën e sigurisë ushqimore, në përgjigje të rasteve të fundit të ekspozimit të konsumatorëve ndaj produkteve të pasigurta dhe jashtë standardeve. Zhvillimet e fundit në vend, duke përfshirë denoncimet publike për shkelje të sigurisë ushqimore ose krimeve mjedisore, kanë rritur ndjeshëm shqetësimin **shoqëror** në lidhje me mungesën e kontrolleve efektive dhe ndëshkimit penal ndaj shkelësve. Në këtë kontekst, prokuroria duhet të forcojë rolin e saj aktiv në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet përgjegjëse. Për më tepër, trajtimi i këtyre çështjeve duhet të jetë prioritar, si **për shkak të** rrezikut të konsiderueshëm për shëndetin publik, ashtu edhe **për** të përforcuar masat parandaluese **dhe për** të **rritur** besimin e qytetarëve në integritetin e zinxhirit të furnizimit me ushqim.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:

249. Numri i procedimeve penale të regjistruara për vepra penale kundër jetës dhe shëndetit të e qytetarëve, sipas veprave penale të përcaktuara në kreun e Kodit Penal.
250. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto vepra penale.
251. Numri i të pandehurve për këto vepra dhe të dhëna lidhur me ta (të mitur në konflikt me ligjin, gra, persona të papërgjegjshëm përpara ligjit).
252. Numri i masave të sigurimit personal dhe masave të marra për sekuestrimin e mjeteve/produkteve të veprës penale sipas K.Penal.
253. Numri i dënimeve të dhëna nga gjykata për këtë kategori veprash penale sipas llojit të veprës.
254. Numri i rasteve të referuara ose për të cilat hetimi është nisur nga institucione të tjera, përveç Policisë së Shtetit, si organet tatimore, doganore, etj..



255. Në sa raste, gjykata ka vendosur dënime plotësuese krahas dënimit kryesor ose autoritetet përkatëse kanë marrë masa administrative ndaj autorëve.

256. Numri i denoncimeve publike ose mediatike që kanë shërbyer për fillimin e hetimeve kryesisht.


(ii) **Vlerësimi**

257.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur plotësisht** kur:

- a. Ka një rritje me të paktën x% të numrit të procedimeve penale të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për vepra penale që lidhen me sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik, krahasuar me vitin e kaluar;
- b. Hetimet për këto çështje përfundojnë në një periudhë më të shkurtër kohore se afati procedural i hetimit dhe kanë trajtim prioritar në regjistrim dhe hetim;
- c. Ka një bashkëpunim aktiv dhe të dokumentuar me institucionet mbikëqyrëse për sigurinë ushqimore dhe mjedisore në mbi x% të rasteve;
- d. Ekzistojnë masa të sigurimit personal dhe sekuestrime të produkteve të rrezikshme, në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, në mbi x% të rasteve;
- e. Mbi x% e hetimeve përfundojnë me dënime dhe nuk pushohen për mungesë provash;
- f. Numri i denoncimeve publike apo mediatike që janë marrë në shqyrtim nga prokuroria dhe që kanë çuar në nisjen e hetimeve është kryesisht mbi x%.

258.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur pjesërisht** kur:

- a. Ka një rritje midis x% - x% në numrin e procedimeve penale të regjistruara dhe dërguara për gjykim për vepra penale që lidhen me sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik, krahasuar me vitet e kaluara;
- b. Hetimet për këto çështje përfundojnë një afat të përafërt me afatin procedural të hetimit;




- c. Ka një bashkëpunim aktiv dhe të dokumentuar me institucionet mbikëqyrëse të sigurisë ushqimore dhe mjedisit midis $x\%$ – $x\%$ të çështjeve;
- d. Ekzistojnë masa të sigurimit personal dhe sekuestrime të produkteve të rrezikshme zbatohen në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, midis $x\%$ - $x\%$ të rasteve;
- e. Midis $x\%$ - $x\%$ e hetimeve përfundojnë me dënime dhe mbyllen për mungesë provash
- f. Numri i denoncimeve publike apo mediatike që janë marrë në shqyrtim nga prokuroria dhe që kanë çuar në nisjen e hetimeve kryesisht është midis $x\%$ - $x\%$.

259.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Ka rënie ose nuk ka rritje të numrit të procedimeve penale të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për vepra penale që lidhen me sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik, krahasuar me vitet e mëparshme;
- b. Hetimet për këto çështje përfundojnë jashtë afateve procedurale të hetimit;
- c. Ka një bashkëpunim aktiv dhe të dokumentuar me institucionet mbikëqyrëse për sigurinë ushqimore dhe mjedisore në më pak se $x\%$ të çështjeve;
- d. Ekzistojnë masa të sigurimit personal dhe sekuestrime të produkteve të rrezikshme, në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, në më pak se $x\%$ të rasteve;
- e. Më pak se $x\%$ e hetimeve përfundojnë me dënime ose më shumë se $x\%$ e hetimeve mbyllen për mungesë provash.
- f. Numri i denoncimeve publike ose mediatike që janë shqyrtuar nga prokuroria dhe që kanë çuar në nisjen e hetimeve është kryesisht më pak se $x\%$.

260.Grupi i mëposhtëm i rekomandimeve ka të bëjë me integritetin, llogaridhënien dhe transparencën e aktiviteteve të prokurorëve dhe prokurorëve.



261. Ruajtja e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës brenda prokurorive është thelbësore për krijimin dhe ruajtjen e shtetit të së drejtës. Pa mekanizma rigorozë për vlerësimin e profesionalizmit dhe standardeve etike të prokurorëve dhe stafit, ekziston rreziku i vendimeve arbitrare, abuzimit me pushtetin dhe humbje të besimit publik. Mbikëqyrja efektive dhe procedurat e qarta sigurojnë që veprimet prokuroriale të ndërmerren në mënyrë të paanshme dhe të bazuar vetëm në prova dhe parime ligjore, jo në presione të jashtme ose interesa personale. Kjo, nga ana tjetër, përforcon besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, pengon korrupsionin dhe mbron të drejtat e të gjitha palëve të përfshira. Në thelb, integrimi i këtyre vlerave në çdo fazë të ndjekjes penale siguron jo vetëm ushtrimin e drejtësisë, por edhe perceptimin e saj si e tillë – një shtyllë kyçe për një shoqëri demokratike dhe funksionale.

(v) Integriteti dhe profesionalizmi në prokurori


262. Rekomandohet zbatim i rigoroz i legjislacionit në fuqi për verifikimin e integritetit dhe profesionalizmit të nëpunësve në prokurori. . Nevoja për zhvillimin e metodave efektive për kontrollin e vazhdueshëm të integritetit dhe profesionalizmit të kandidatëve dhe personelit duhet të shtrihet përtej fushës së procesit të vetting-ut të bërë në kuadër të reformës së ndërmarrë në sistemin e drejtësisë.

263. Theksohet se, në përputhje me Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përgjegjësia për rekrutimin, emërimin dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve i takon ekskluzivisht Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për pasojë, ky rekomandim duhet të interpretohet si i aplikueshëm vetëm për oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë dhe për personelin administrativ të Prokurorisë, duke përjashtuar prokurorët nga fushëveprimi i tij.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen:

264. Sa është numri i përgjithshëm i verifikimeve të kryera për të verifikuar integritetin dhe profesionalizmin e punonjësve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK?

265. Sa është numri i përgjithshëm i informacioneve të cilat i janë përcjellë prokurorisë nga palët e treta për kandidatin/të punësuarin në prokurori apo nga njësitë e sinjalizimit të institucionit? Cilat janë mënyrat



e tjera të përdorura për verifikimin e kandidatëve/të punësuarve të tjerë në prokurori, sipas ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar dhe ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar?

266. Të përcaktohet nëse ka akte të tjera nënligjore në bazë të të cilave kryhet verifikimi dhe nëse aktet janë të miratuara nga drejtuesi i prokurorisë, apo Prokurori i Përgjithshëm, si dhe nëse aktet janë përditësuar në kuadër të verifikimit të kandidatëve/të punësuarve në prokurori.

267. Cilat janë metodat aktuale të përdorura për të verifikuar integritetin dhe profesionalizmin e kandidatëve për punësim në prokurori? A janë këto metoda të përditësuara për të pasqyruar ndryshimet ligjore dhe nevojat e sistemit të drejtësisë? A ekziston një mekanizëm për monitorimin dhe verifikimin e vazhdueshëm të integritetit të të punësuarve në këto struktura? Sa nëpunës i janë nënshtruar vlerësimit sipas këtyre metodave dhe çfarë rezultatesh janë konstatuar? A janë trajnuar prokurorët në aplikimin e këtyre metodave të reja?


(ii) Vlerësimi

268. Rekomandimi do të konsiderohet i **përbushur plotësisht** kur:

- a. janë miratuar ___ udhëzime ose akte të posaçme që formojnë metodat e vlerësimit *ex post*, të integritetit dhe profesionalizmit;
- b. mbi ___% e kandidatëve/punonjësve i janë nënshtruar vlerësimit me metoda të strukturuar;
- c. Sistemi për kontrollin e vazhdueshëm të integritetit të punonjësve dhe kandidatëve ekziston dhe zbatohet në mënyrë periodike sipas një kalendarit të miratuar nga drejtuesi i prokurorisë.

269. Rekomandimi do të konsiderohet i **përbushur pjesërisht** kur:

- a. Ekzistojnë disa akteve të posaçme që formojnë *metodat e vlerësimit ex post*, të integritetit dhe profesionalizmit;



- b. deri në ____% e kandidatëve/punonjësve i janë nënshtruar vlerësimit me metoda të strukturuar;
- c. Sistemi për kontrollin e vazhdueshëm të integritetit të punonjësve dhe kandidatëve ekziston dhe nuk zbatohet në mënyrë periodike sipas kalendarit të miratuar nga drejtuesi i prokurorisë.

270.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. nuk është miratuar asnjë akt në kuadër të vlerësimit *ex post* të kandidatëve/punonjësve;
- b. më pak se ____% e kandidatëve/punonjësve i janë nënshtruar vlerësimit me metoda të strukturuar;
- c. Mungon një sistem për kontrollin e vazhdueshëm të integritetit të punonjësve dhe kandidatëve të prokurorisë.

(ë) Rregullorja e Brendshme e Prokurorisë

271.Rekomandohet rishikimi i akteve të brendshme që rregullojnë funksionimin e prokurorisë, me synim krijimin e një sistemi transparence dhe llogaridhënie. Ky proces duhet të shoqërohet me udhëzime dhe standarde të qarta, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kriteret më të mira ndërkombëtare, që zbatohen për organet akuzuese, të cilat duhet të jenë të disponueshme për publikun.

272.Sigurimi i proceseve të vlerësimit, rregulloreve të brendshme transparente dhe mekanizmave të qëndrueshëm për llogaridhënie është thelbësor për nxitjen e besimit të publikut dhe forcimin e integritetit institucional të prokurorisë. Këto masa jo vetëm që ndihmojnë në vlerësimin e vazhdueshëm të profesionalizmit dhe etikës së kandidatëve dhe personelit, por gjithashtu harmonizojnë legjislacionin kombëtar me standardet e njohura ndërkombëtare. Publikimi dhe rishikimi i rregullt i akteve dhe udhëzimeve të brendshme, në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të aksesueshme tregojnë angazhimin e prokurorisë për transparencë, qëndrueshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm. Kjo qasje mbështet drejtësinë dhe forcon legjitimitetin e vendimeve në sytë e qytetarëve.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen për secilën prokurori



273.A janë rishikuar dhe përditësuar aktet e brendshme të prokurorisë për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie institucionale, në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare, dhe a janë këto akte të disponueshme për publikun?

274.A është realizuar procesi i rishikimit të akteve të brendshme të prokurorisë në lidhje me organizimin, funksionimin dhe raportimin? A përfshihet përafrimi me standardet ndërkombëtare të transparencës dhe llogaridhënies (opinionet e ÇPE, GRECO, rekomandimet e OSBE-së, etj.) në këtë proces? Sa prej akteve nënligjore në fuqi janë rishikuar në kuadër të ndjekjes së këtij rekomandimi dhe sa prej tyre janë bërë të njohura për publikun për aq sa është e mundur? A janë udhëzimet dhe standardet e reja të miratuara të aksesueshme dhe a ka mekanizma për zbatimin e tyre? A ka struktura apo persona përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të transparencës?

(ii) Vlerësimi

275.Rekomandimi do të konsiderohet **i përmbushur plotësisht** kur:

- a. Mbi ____% e akteve të rëndësishme janë rishikuar dhe përditësuar;
- b. Mbi _____% e akteve të rishikuara përmbajnë referenca të qarta dhe janë në përputhje me praktikatat e rekomanduara ndërkombëtare;
- c. Mbi ____% e akteve janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

276.Rekomandimi do të konsiderohet **i përmbushur pjesërisht** kur:

- a. Deri në _____% të akteve të rëndësishme janë rishikuar dhe përditësuar;
- b. Deri në _____% e akteve të rishikuara përmbajnë referenca të qarta dhe janë në përputhje me praktikatat e rekomanduara ndërkombëtare;
- c. Deri në _____% e akteve janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

277.Rekomandimi do të konsiderohet **i papërmbushur** kur:



- a. Më pak se ____% e akteve të rëndësishme janë rishikuar dhe përditësuar;
- b. Më pak se ____% e akteve të rishikuara përmbajnë referenca të qarta dhe janë në përputhje me praktikatat e rekomanduara ndërkombëtare;
- c. Më pak se ____% e akteve janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

(x) Zbatimi, rishikimi dhe përditësimi i akteve procedurale

278.Rekomandohet shqyrtimi dhe përditësimi i modeleve ekzistuese, dhe kur është i nevojshëm, standartizimi i modeleve të akteve procedurale, dokumenteve administrative plotësuese të përdorura në punën e përditshme të prokurorëve dhe prokurorive, me qëllim garantimin e unifikimit të praktikave institucionale dhe lehtësimin e punës së përditshme.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

279. A është rishikuar dhe aplikuar një model standard dokumentacioni administrativ për punën e përditshme të prokurorëve, i cili garanton unifikimin e praktikës dhe është i njohur për publikun?

280.A është zhvilluar një proces institucional për identifikimin e praktikave të dokumentimit (të tilla si shkresat përcjellëse, aktet e kalimit të dosjeve midis seksioneve, procesverbalee shpenzimeve, modelet e kërkesave të prokurorëve për çështje të ngjashme të ngjashëm), që kanë nevojë për standardizim?

281.A garantojnë këto modele respektimin unifikimin e praktikës së përditshme dhe lehtësimin e punës së përditshme (model i qartë dhe i shkurtër, respektimi i formateve administrative, përdorimi i gjuhës së qartë)? A janë këto modele të publikuara ose të aksesueshme për publikun, aty ku lejohet ligjërisht ose është e përshtatshme, në mënyrë që të rritet transparencja dhe njohja e të drejtave?

(ii) Vlerësimi

282.Rekomandimi do të konsiderohet i **përmbushur plotësisht**, kur:

- a. Janë miratuar _____ akte nënligjore në kuadër të standardizimit dhe unifikimit të veprimtarisë së prokurorëve dhe punonjësve administrativ;



- b. _____, nga modelet e miratuara parashikon qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në proces;
- c. Më shumë se _____% e modeleve të miratuara administrative janë lehtësisht të aksesueshme për subjektet procedurale përkatëse.

283.Rekomandimi do të konsiderohet i përmbushur pjesërisht kur:

- a. Janë miratuar _____ akte nënligjore në kuadër të standardizimit dhe unifikimit të veprimtarisë së prokurorëve dhe punonjësve administrativ;
- b. _____, nga modelet e miratuara, siguron në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në proces;
- c. Deri në _____% e modeleve të miratuara janë lehtësisht të aksesueshme për subjektet procedurale përkatëse.

284.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërmbushur** kur:

- a. Nuk është miratuar asnjë akt nënligjor në kuadër të standardizimit dhe unifikimit të veprimtarisë së prokurorëve dhe punonjësve administrativ;
- b. Asnjë nga modelet e miratuara nuk parashikon qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në proces;
- c. Më pak se _____% e modeleve të miratuara janë lehtësisht të aksesueshme për subjektet procedurale përkatëse.

(y) Shqyrtimi i brendshëm i mekanizmit të ankimeve

285.Në vlerësimin e kësaj pike, është e rëndësishme që vlerësimi të zhvillohet në përputhje me Ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, veçanërisht duke vëzhguar rolet dhe kompetencat e veçanta që synojnë të parandalojnë mbivendosjen juridiksionale. Shqyrtimi i ankimeve, nisja e hetimeve dhe referimi i çështjeve duhet të jenë në përputhje me përgjegjësitë dhe autoritetin që i takon Këshillit të



Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në lidhje me procedurat disiplinore. Çdo masë ose mekanizëm i brendshëm që zhvillohet duhet të plotësojë strukturat formale disiplinore të përshkruara në ligj, duke ruajtur kufijtë e qartë të kompetencave institucionale dhe duke mbështetur një proces disiplinor të thjeshtë dhe ligjërish të qëndrueshëm.

286.Rekomandohet ndërmarrja e veprimeve konkrete për shqyrtimin e plotë të ankimeve apo nisjen e hetimeve, kryesisht në rastet kur vërehet se mund të ketë arsye dhe indicie të mjaftueshme për nisjen e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe referimin e rasteve pranë organet kompetente. Marrja e masave të tilla duhet të shërbejë për të parandaluar kryerjen e veprimeve, në kundërshtim me ligjin, dhe si rezultat, të kontribuojë në zëvendësimin e qasjes neglizhente, duke reduktuar tolerancën ndaj praktikave korruptive.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

287.A janë konstatuar raste ankimi nga subjektet dhe indicie për shkelje nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, për të garantuar një reagim disiplinor efektiv dhe për të zvogëluar tolerancën ndaj praktikave abuzive dhe korruptive?


288.Sa janë rastet kur janë identifikuar dhe referuar indicie të mjaftueshme për nisjen e hetimeve disiplinore ndaj prokurorëve/oficerëve? A është kryer një analizim i këtyre shkeljeve administrative ose disiplinore? A janë marrë masa parandaluese për të forcuar integritetin dhe për të shmangur praktikat abuzive?

289.Cilat janë burimet e informacionit të strukturave/personave përgjegjës të prokurorisë në kuadër të verifikimit të shkeljeve disiplinore/veprave penale të kryera nga funksionarët/punonjësit e prokurorisë?

290.Sa është numri i rasteve të njoftimit nga gjykata për shkelje procedurale ose shkelje të tjera, të kryera nga prokurorët, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, dhe si janë trajtuar ato?

291.Sa është numri i rasteve të referuara pranë organeve përkatëse, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi në rast se ka dyshime të arsyeshme se shkelja është kryer në bashkëpunim me një gjyqtar?

(ii) Vlerësimi



292.Rekomandimi do të konsiderohet i **përmbyshur plotësisht** kur:

- a. Mbi _____% e ankimeve janë shqyrtuar dhe janë ndërmarrë veprime të dokumentuara;
- b. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë/Prokurori i kanë referuar më shumë se _____ çështje, pranë strukturave përkatëse disiplinore;
- c. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë/prokurori kanë nisur hetimet për _____ raste të shkeljeve të natyrës penale;
- d. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë, ka miratuar _____ akte nënligjore me qëllim ndërmarrjen e masave parandaluese sistematike për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

293. Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbyshur** kur:

- a. Deri në _____% e ankimeve janë shqyrtuar dhe janë ndërmarrë veprime të dokumentuara;
- b. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë/Prokurori, ua kanë referuar çështjen _____ strukturave përkatëse disiplinore;
- c. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë/Prokurori kanë nisur hetimet për _____ raste të shkeljeve të natyrës penale;
- d. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë, ka miratuar _____ akte nënligjore për ndërmarrjen e masave parandaluese sistematike për prokurorët dhe punonjësit e policisë gjyqësore.

294. Rekomandimi do të konsiderohet i **papërmbyshur** kur:

- a. > _____ të ankimeve janë shqyrtuar dhe janë ndërmarrë veprime të dokumentuara;
- b. Prokurori i Përgjithshëm/ Drejtuasi i Prokurorisë /Prokurori nuk kanë referuar asnjë rast në strukturat përkatëse disiplinore;
- c. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë/Prokurori, nuk kanë ndërmarrë asnjë hetim për rastet e shkeljeve të natyrës penale;
- d. Prokurori i Përgjithshëm/Drejtuasi i Prokurorisë nuk ka miratuar asnjë akt nënligjor për të ndërmarrë masa parandaluese në mënyrë sistematike për prokurorët dhe punonjësit e policisë gjyqësore.



(z) **Përgjegjësia disiplinore**

295. Llogaridhënia e brendshme krijon një proces pavarësie dhe promovon perceptimin publik për një sistem ankesash, që është lehtësisht i aksesueshëm për publikun dhe shoqërinë civile. Procedurat për hetimin e shkeljeve dhe rezultatet e këtyre hetimeve duhet të përshtaten në mënyrë efektive dhe transparente për publikun për atë që është e mundur.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen**

296. A ka krijuar Prokuroria një sistem të aksesueshëm, të pavarur dhe transparent për trajtimin e ankimeve nga publiku dhe a pasqyrohet ky sistem në vlerësimet e brendshme të performancës, edhe në rastet kur shkelja nuk vërtetohet, por ka dyshime për këtë?

297. A ekziston një sistem funksional për paraqitjen e ankimeve nga publiku dhe shoqëria civile, i cili është lehtësisht i aksesueshëm (*online*, fizikisht, në gjuhë të kuptueshme)? A janë rregulloret dhe procedurat për hetimin e shkeljeve të strukturuar për të siguruar pavarësi, paanshmëri dhe efikasitet? A bëhen publike rezultatet e hetimeve (në formë agregate ose anonime) dhe a përdoren për analiza për të përmirësuar aktet dhe procedurat e brendshme? A ekziston një mekanizëm reflektimi i brendshëm për rastet kur, ndërsa një shkelje nuk është vërtetuar, dyshimi është konsideruar mjaft serioz për të rishikuar praktikën institucionale?

(ii) **Vlerësimi**

298. Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Sistemi i ankimeve është funksional në *modalitetin online*, në shqip dhe anglisht, me udhëzime të qarta për përdoruesin, si dhe fizikisht me ndihmën e personelit të Prokurorisë, për shtetasit shqiptarë dhe të huaj;
- b. Rezultatet e hetimeve janë transparente dhe përditësohen periodikisht në faqen zyrtare të Prokurorisë përkatëse, duke përfshirë veprimet e kryera në kuadër të hetimeve, si dhe një pasqyrim të objektit dhe masës së marrë;
- c. Në më shumë se _____% të rasteve me dyshime të arsyeshme, aktet nënligjore të brendshme janë rishikuar.

299. Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:



- a. Sistemi i ankimeve është funksional, por aksesueshmëria është e kufizuar (vetëm në zyrën fizike, pa një udhëzim të qartë);
- b. Rezultatet e hetimeve janë transparente, por nuk përditësohen periodikisht në faqen zyrtare të Prokurorisë përkatëse;
- c. Në ____% të rasteve me dyshime të arsyeshme, është kryer një rishikim i akteve nënligjore të brendshme.

300.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Sistemi i ankimeve nuk ekziston/nuk është funksional/formalisht ka një sistem të aksesueshëm, por nuk është funksional;
- b. Rezultatet e hetimeve nuk janë transparente dhe nuk përditësohen periodikisht në faqen zyrtare të Prokurorisë përkatëse;
- c. Mungojnë shqyrtimet, edhe aty ku ka dyshime serioze.


(aa) Sistemi i kontrollit të zbatimit të ligjit

301. Ndërsa legjislacioni konsiderohet gjithëpërfshirës, duke përbajtur rregulla që përputhen me standardet ndërkombëtare dhe institucionet janë krijuar në përputhje me këto standarde, zbatimi praktik i tij në aspektin e transparencës dhe llogaridhënies mbetet një sfidë. Në këtë kontekst, rekomandohet rritja e kapaciteteve në përdorimin e të gjithë mekanizmave të parashikuar nga legjislacioni, me qëllim që të garantohet objektiviteti dhe transparenca e veprimtarisë së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

302. A janë të mjaftueshme kapacitetet e Prokurorisë dhe institucioneve të tjera relevante, për të përdorur në mënyrë efektive të gjithë mekanizmat e parashikuar nga legjislacioni për transparencën dhe llogaridhënien e veprimtarisë së prokurorëve dhe zyrtarëve të policisë gjyqësore?

303. A janë të disponueshme dhe përdoren të gjitha mjetet ligjore dhe mekanizmat për transparencë dhe llogaridhënie në Prokurori? A janë trajnuar të gjithë punonjësit e sistemit të drejtësisë në përdorimin dhe zbatimin e këtyre mekanizmave ligjorë? A është përmirësuar përdorimi i teknologjisë dhe sistemeve të menaxhimit të informacionit për të rritur transparencën dhe llogaridhënien? A është



rritur ndjeshëm objektiviteti dhe efikasiteti në zbatimin e procedurave për hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve, duke siguruar një proces të paanshëm dhe të drejtë për të gjitha palët e përfshira?

(ii) **Vlerësimi**

304. Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Të gjithë mekanizmat ligjorë janë përdorur rregullisht dhe në mënyrë efektive për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie;
- b. Më shumë se _____% e stafit të Prokurorisë janë trajnuar dhe kanë njohuri për mekanizmat e transparencës;
- c. Janë përdorur sisteme dhe teknologji të avancuara që mundësojnë transparencë dhe rrisin efikasitetin e procesit të hetimit;
- d. Proceset janë objektive, të paanshme, efektive dhe të drejta për të gjitha palët e përfshira.

305. Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Mekanizmat janë përdorur në disa raste, por nuk janë të përshtatshëm dhe të disponueshëm për çdo rast;
- b. Deri në _____% e stafit të Prokurorisë janë trajnuar dhe kanë njohuri për mekanizmat e transparencës;
- c. Teknologjia përdoret në disa nivele, por ka mangësi në zbatimin e saj të plotë;
- d. Disa procedura janë të paanshme dhe të drejta, por ka mangësi në efikasitet dhe transparencë.

306. Rekomandimi do të konsiderohet **i papërmbushur** kur:

307. Mekanizmat për transparencë dhe llogaridhënie mungojnë ose përdorimi i tyre është i kufizuar;


308. Më pak se _____% e stafit të Prokurorisë janë trajnuar dhe kanë njohuri për mekanizmat e transparencës;

309. Mungojnë sistemet efektive për menaxhimin e informacionit dhe transparencën;

310. Procedurat ngjallin dyshime për palët dhe nuk janë transparente, duke çuar në shkelje të mundshme të të drejtave të palëve.

(bb) **Standardet dhe etika profesionale**

311. Në bashkëpunim me KLP është e nevojshme përditësimi periodik i rregullave të etikës për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administratën e prokurorisë, në përputhje me



standardet e BE-së dhe kërkesat e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në sjelljen etike dhe profesionale. Ky rishikim duhet të sigurojë që këto standarde të jenë në përputhje dhe që rregullat të jenë të zbatueshme për të gjitha Prokuroritë. Për më tepër, duhet të sigurohet publikimi i plotë dhe i drejtpërdrejtë i këtyre rregullave, si dhe qasja publike në to për ndërgjegjësim dhe njohje. Zhvillimi i aktiviteteve që synojnë promovimin e njohjes dhe zbatimit praktik të tyre përbën një rekomandim shtesë për të dy institucionet.

312. Ndërsa miratimi dhe mbikëqyrja e standardeve etike bien plotësisht në kompetencën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), ka një nevojë urgjente që institucioni të zhvillojë dhe zbatojë standarde të brendshme të forta dhe udhëzime gjithëpërfshirëse që rregullojnë sjelljen etike. Krijimi i kornizave të tilla të brendshme jo vetëm që do të përforconte përafrimin me pritshmëritë e BE-së dhe ndërkombëtare, por gjithashtu do të nxiste një sjellje etike të qëndrueshme në të gjitha nivelet e ndjekjes penale. Këto standarde duhet të jenë të shprehura qartë, lehtësisht të aksesueshme dhe të integruara në mënyrë aktive në praktikën e përditshme, duke forcuar kështu integritetin institucional dhe besimin e publikut në sistemin e prokurorisë.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

313. A janë rregullat e etikës për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administratën e Prokurorisë të përditësuar dhe në përputhje me standardet e BE-së, dhe me kërkesat ndërkombëtare për transparencë, llogaridhënie dhe sjellje profesionale?
314. A janë rishikuar dhe përshtatur rregullat e etikës për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për të përmbushur kërkesat e standardeve të BE-së? Sa nga aktet janë rishikuar dhe përshtatur me këto rregulla?
315. A janë këto rregulla të zbatueshme për të gjitha prokuroritë?
316. A janë publiku dhe shoqëria civile plotësisht të informuara dhe mund t'i qasen lehtësisht këtyre rregullave? A ka pasur një aktivitet të vazhdueshëm për njohjen dhe zbatimin praktik të rregullave të etikës nga stafi i Prokurorisë?

(ii) Vlerësimi

317. Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:



- a. Aktet nënligjore që përcaktojnë rregullat e etikës janë plotësisht të përditësuara dhe të përshtatura me standardet e BE-së dhe kërkesat ndërkombëtare;
- b. Rregullat zbatohen për më shumë se ____% të prokurorive dhe janë të zbatueshme në të gjitha prokuroritë dhe nuk ka mangësi në zbatim;
- c. Rregullat e etikës janë të disponueshme dhe të aksesueshme në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë për publikun dhe shoqërinë civile në faqen zyrtare të Prokurorisë dhe të postuara pranë tyre;
- d. ____ janë zhvilluar aktivitete dhe trajnime të vazhdueshme gjithëpërfshirëse për njohjen dhe zbatimin praktik të rregullave të etikës.

318.Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:


- a. Disa nga aktet nënligjore që rregullojnë rregullat e etikës janë përditësuar dhe përshtatur, por ka ende mangësi në harmonizim me standardet ndërkombëtare;
- b. rregullat zbatohen deri në ____% të prokurorive dhe janë të zbatueshme në të gjitha prokuroritë dhe nuk ka mangësi në zbatim;
- c. Rregullat e etikës janë të disponueshme, por mund të ketë vështirësi në qasjen e plotë tek ato;
- d. ____ janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme dhe trajnime gjithëpërfshirëse për njohjen dhe zbatimin praktik të rregullave të etikës.

319.Rekomandimi do të konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. Aktet nënligjore që rregullojnë rregullat e etikës, nuk janë të përditësuara dhe nuk përputhen me standardet e BE-së;
- b. Rregullat e etikës zbatohen në më pak se ____% të të gjitha prokurorive;
- c. Rregullat nuk publikohen dhe nuk mund të aksesohen lehtësisht nga publiku;
- d. Janë kryer më pak se ____ aktivitete të vazhdueshme dhe trajnime të plota për njohjen dhe zbatimin praktik të rregullave të etikës.

(bb) Sistemi i automatizuar i shpërndarjes së çështjeve

320.Rekomandohet marrja e masave për funksionimin e plotë dhe efikas të sistemit të ndarjes së çështjeve, për të siguruar përmirësimin e ecurisë së hetimeve për çështjet, si dhe për të nxitur transparencën dhe



llogaridhënien e Prokurorisë në procedurat përkatëse. Ky sistem gjithashtu duhet të sigurojë akses në të dhëna, si dhe të garantojë paanshmëri dhe konfidencialitet.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen**

321. A funksionon plotësisht sistemi i shpërndarjes së çështjeve, me efikasitet, transparencë dhe me paanshmëri, duke siguruar akses në të dhëna dhe duke mbrojtur konfidencialitetin?
322. A është sistemi i shpërndarjes së çështjeve aktiv dhe funksional në të gjitha prokuroritë? A garanton ky sistem ndarjen automatike, rastësore dhe të paanshme të çështjeve, në përputhje me dispozitat e nenit 42 të Ligjit Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar? A ekziston mundësia e ndërhyrjes në këtë sistem, nga personat që e kanë këtë autorizim, për të ndikuar në shpërndarjen selektive të çështjeve? A është ky sistem i aksesueshëm dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, me qëllim të garantimit të aksesit dhe ndërveprimit të të dhënave me institucionet përkatëse? A është sistemi i pajisur me mekanizma që sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave të ndjeshme? A është sistemi i aksesueshëm për administrimin e prokurorisë dhe strukturat e inspektimit për qëllime të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm?

(ii) **Vlerësimi**

323.Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Sistemi është aktiv dhe funksional në të gjitha prokuroritë dhe funksionon pa ndërprerje apo devijime;
- b. Shpërndarja e çështjeve bëhet automatikisht, në mënyrë rastësore dhe me transparencë, duke respektuar dispozitat e nenit 42 të Ligjit Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- c. Sistemi krijon raporte në mënyrë të rregullt, të cilat janë të aksesueshme nga palët përkatëse në përputhje me dispozitat e ligjit nr.115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- d. Sistemi garanton mbrojtjen e të dhënave dhe ka mekanizma sigurie të mirëpërcaktuara.

324.Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:



- a. Sistemi funksionon vetëm në disa zyrë, ose ka raste të ndërprerjeve ose përjashtimeve;
- b. Shpërndarja e çështjeve bëhet pjesërisht automatikisht, por ka përjashtime ose ndërhyrje në mënyrë manuale;
- c. Sistemi krijon raporte në mënyrë të rregullt, por nuk është i aksesueshëm nga palët përkatëse në përputhje me dispozitat e ligjit nr.115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- d. Sistemi ka mekanizma të pjesshëm për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave, por ato nuk janë të standardizuara për të gjitha rastet.

325.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Sistemi nuk funksionon ose është jofunksional;
- b. Shpërndarja e çështjeve nuk bëhet në mënyrë rastësore ose automatikisht dhe bëhet në çdo rast në mënyrë manuale;
- c. Sistemi nuk krijon raporte dhe nuk është i aksesueshëm nga palët përkatëse në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.115/2016 "Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;
- d. Nuk ka masa të mjaftueshme për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave ose nuk zbatohen.

(ç) E drejta e aksesit në informacion

326.Prokuroria duhet të përcaktojë qartë vijën ndarëse midis detyrimit për ruajtjen e sekretit hetimor, respektimit të së drejtës për informacion dhe qasje në dosje, si dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë qëllim, rekomandohet të krijohet një metodologji e qartë për përdorimin e informacionit që përbën sekret hetimor, duke respektuar detyrimet ligjore për secilën prej këtyre fushave.

(i) Të dhënat që duhet të mbliidhen

327.A ka prokuroria një metodologji të qartë dhe të zbatueshme për të balancuar detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë hetimore me të drejtën për informim, aksesin në dosjen penale dhe mbrojtjen e të dhënave personale?

328.A është miratuar një dokument udhëzues/metodologjik nga Prokuroria për përdorimin dhe kufizimin e informacionit që përbën sekret hetimor? A është trajnuar stafi për zbatimin e kësaj metodologjie dhe për menaxhimin e informacionit konfidencial? A janë të standardizuara procedurat për dhënien ose kufizimin e aksesit në dosjet penale dhe të dhënat personale për palët e interesuara (avokatët, mediat,

shoqëria civile)? A monitorohet zbatimi i këtyre rregullave dhe a ka pasur ankime për shkelje të së drejtës për informacion apo rrjedhje të dhënash?

(ii) **Vlerësimi**

329.Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar një udhëzim/metodologji që përcakton qartë kufizimin e informacionit që përbën sekret hetimor dhe përcaktimin e ekuilibrit midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim;
- b. Ekuilibri midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim përcaktohet qartë duke përcaktuar standarde dhe kritere uniforme, të cilat zbatohen vazhdimisht nga prokurorët;
- c. Në ____% të rasteve të kërkesave për informacion nga palët, shoqëria civile dhe mediat, prokurorët kanë lejuar aksesin në dosje/dhënien e informacionit;
- d. Stafit është trajnuar rregullisht dhe _____ janë organizuar trajnime për zbatimin e ekuilibrit midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim.
- e. Dokumenti i miratuar publikohet në faqen zyrtare të prokurorisë dhe/ose në Gazetën Zyrtare, si dhe shfaqet në të gjitha prokuroritë dhe është i aksesueshëm për palët e interesuara (publiku, mediat, organizatat e shoqërisë civile).
- f. Më shumë se ____% e kërkesave të palëve/gazetarëve/shoqërisë civile trajtohen në përputhje me dispozitat e udhëzimit/metodologjisë së miratuar.

330.Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar një udhëzim/metodologji, por kufizimi i informacionit që përbën sekret hetimor nuk është i qartë për publikun e gjerë;
- b. Ekuilibri midis fshehtësisë së hetimit dhe të drejtës për informim nuk është i përcaktuar qartë, por prokurorët veprojnë rast pas rasti;
- c. Në ____% të rasteve të kërkesave për informacion nga partitë, shoqëria civile dhe mediat, prokurorët kanë lejuar aksesin në dosje/dhënien e informacionit;
- d. Stafit është trajnuar dhe _____ janë organizuar trajnime për zbatimin e ekuilibrit midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim.



- e. Dokumenti është miratuar, por nuk është lehtësisht i aksesueshëm për publikun (nuk publikohet në internet ose ka mungesë transparence për përmbajtjen e tij në më shumë se _____ prokurori).
- f. _____% e kërkesave të palëve/gazetarëve/shoqërisë civile trajtohen në përputhje me dispozitat e udhëzimit/metodologjisë së miratuar.

331.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Prokurori i Përgjithshëm nuk ka miratuar asnjë akt që përcakton ekuilibrin midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim;
- b. Nuk është bërë asnjë përpjekje për të vendosur një ekuilibër midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim, dhe prokurorët kanë një qasje kufizuese ndaj kërkesave që marrin nga palët;
- c. Në më pak se _____% të rasteve të kërkesave për informacion nga palët, shoqëria civile dhe mediat, prokurorët kanë lejuar aksesin në dosje/dhënien e informacionit;
- d. Stafit nuk është trajnuar për zbatimin e ekuilibrit midis sekretit hetimor dhe të drejtës për informim.
- e. Dokumenti nuk është publikuar ose nuk është miratuar ende; Nuk ka transparencë në lidhje me përmbajtjen e politikës për kufizimin e informacionit.
- f. Më pak se _____% e kërkesave të palëve/gazetarëve/shoqërisë civile trajtohen në përputhje me dispozitat e udhëzimit/metodologjisë së miratuar.

(dd) Mbrojtja e të dhënave personale

332.Në përputhje me legjislacionin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, prokuroria duhet të vendosë rregulla të qarta, për mbrojtjen dhe respektimin e të dhënave të subjekteve të hetimit nga punonjësit që kanë këto të dhëna për shkak të detyrës së tyre.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

333.A ka vendosur prokuroria rregulla të qarta dhe të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të hetimit nga punonjësit që kanë akses në këto të dhëna për shkak të detyrës së tyre?


334. A është miratuar një akt i brendshëm (udhëzime, rregulloret, politike institucionale) për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe aktet nënligjore përkatëse? A ka mekanizma kontrolli dhe llogaridhënieje për punonjësit që administrojnë të dhënat personale (të tilla si auditimet e brendshme, regjistrat e aksesit (hyrjeve), etj.)? A është trajnuar stafi për standardet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe detyrimet e konfidencialitetit? A është caktuar një Zyrtar i Mbrojtjes së të Dhënave (ZMDH) në përputhje me ligjin përkatës? A ka raste të raportuara të shkeljes dhe abuzimit me të dhënat personale dhe si janë trajtuar ato? A ka raste të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe cili është përfundimi i tyre?

(ii) **Vlerësimi**

335. Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. Rregulloret/udhëzimet/aktet institucionale miratohen nga strukturat përkatëse dhe zbatohen në të gjitha Prokuroritë;
- b. Personeli i prokurorisë është trajnuar _____ trajnime sistematike mbi standardet që duhet të ndjekin në lidhje me informacionin dhe të dhënat personale që janë të njohura për shkak të detyrës. Trajnimet janë të dokumentuara, të shtrira në të gjitha prokuroritë dhe të shoqëruara me materiale informuese, teste pas trajnimit dhe monitorim të zbatimit në praktikë;
- c. ZMDH-ja emërohet zyrtarisht dhe ushtron funksionet e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi (mbikëqyrja e zbatimit të rregullave, këshillimi i stafit, menaxhimi i riskut, raportimi). Për këtë, ka një plan vjetor pune, mban dokumentacionin për aktivitetet dhe raporton periodikisht, të paktën çdo muaj, tek drejtuesit e prokurorisë dhe, sipas rastit, tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- d. Ekziston një sistem i dokumentuar për raportimin e shkeljeve të të dhënave personale, me procedura të qarta për njoftimin e menjëhershëm, hetimin e brendshëm dhe vendosjen e masave disiplinore. Kallëzimet për shkelje analizohen, trajtohen në kohë dhe i referohen autoritetit kompetent sipas ligjit. Stafi është i vetëdijshëm dhe i trajnuar për këto procedura.


336. Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:



- a. Rregulloret/udhëzimet/aktet institucionale miratohen nga strukturat përkatëse dhe zbatohen në më shumë se _____% të të gjitha Prokurorive;
- b. Personeli i prokurorisë është trajnuar pjesërisht – disa trajnime janë kryer në kohë të kufizuar ose në mbulim gjeografik. Trajnimet nuk janë zhvilluar sistematikisht për të gjithë punonjësit dhe nuk ka program të përhershëm për përditësimin e njohurive mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Dokumentacioni dhe ndjekja e zbatimit është e paplotë ose jokonsistente;
- c. ZMDH-ja është emëruar, por nuk ka funksion aktiv të dokumentuar ose mungojnë raportet periodike. Aktivitetet e tij janë të paqarta, ose nuk ka qenë i përfshirë në menaxhimin e rrezikut të privatisisë ose proceset e këshillimit të personelit. Raportet janë të rralla, jo të standardizuara ose lëshohen vetëm në përgjigje të çështjeve.
- d. Janë raportuar raste të izoluara të shkeljeve, por nuk ka një sistem të qëndrueshëm dhe të strukturuar të ndjekjes së tyre. Procedurat janë të fragmentuara ose nuk zbatohen në mënyrë uniforme. Nuk ka dokumentacion të plotë mbi hetimet ose masat ndëshkuese. Staf i ka njohuri të pjesshme për detyrimet në lidhje me këtë çështje.

337.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërmbyshur** kur:

- a. Rregulloret/udhëzimet/aktet institucionale nuk miratohen nga strukturat përkatëse;
- b. Nuk është kryer asnjë trajnim specifik ose i strukturuar për personelin e prokurorisë, në lidhje me qasjen që duhet të kenë në informacione dhe të dhëna personale, për të cilat ata janë në dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tyre. Nuk ka asnjë program trajnimi të dedikuar dhe nuk ka dokumentacion për të rritur ndërgjegjësimin ose për t'u ofruar punonjësve udhëzime të qarta në këtë fushë.
- c. Asnjë ZMHD nuk është emëruar në institucion ose figura e ZMDH-së nuk është funksionale. Për këtë, nuk ka aktivitet të dokumentuar, plan pune ose raportim për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale.
- d. Nuk ka asnjë mekanizëm formal për të raportuar, hetuar ose adresuar shkeljet e të dhënave personale. Për këtë, nuk ka raste të raportuara zyrtarisht ose raste të tilla nuk janë të dokumentuara. Për këtë aspekt, nuk ka ndërgjegjësim institucional dhe mungojnë qartë masat e llogaridhënies.



338. Seksionet e mëposhtme do të trajtojnë rekomandimet për sigurimin e efikasitetit dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

ee) Çështjet e prapambetura

339. Për të zvogëluar numrin e çështjeve të prapambetura, vonesat e shkaktuara nga numri i madh i çështjeve, si dhe për të rritur cilësinë e hetimeve dhe thellësinë e tyre, rekomandohet krijimi i seksioneve ose task forcave për t'u marrë në mënyrë të specializuar me veprat penale që janë komplekse për t'u hetuar dhe kërkojnë njohuri të specializuara për hetimin e tyre. Kjo bëhet për të zvogëluar kohën e nevojshme për të përfunduar hetimet dhe për të përqendruar veprimet e duhura hetimore në krime si: korrupsioni, krimet e jakave të bardha, mashtrimi, çdo vepër tjetër penale financiare, si dhe veprat penale të dhunshme të kryera në kuadër të organizatave kriminale ose terroriste.


340. Ndërsa pranohet se ky numër i çështjeve të prapambetura, është një çështje e kahershme që prokuroritë kanë ndërmarrë hapa për ta adresuar, është e rëndësishme të theksohet adresimi në një nivel sistematik.

(i) Të dhënat që duhet të mbliqhen

341. Numri i seksioneve ose task forcave të specializuara, të themeluara, të dokumentuara përmes vendimeve administrative, udhëzimeve të brendshme ose strukturave organizative të ndryshuara.
342. Numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të caktuar në këto njësi.
343. Numri i çështjeve të trajtuara nga këto njësi të specializuara, të ndara nga natyra e veprës, korrupsioni, krimi ekonomik/financiar, mashtrimi, krimi i organizuar i dhunshëm, terrorizmi etj.
344. Numri i çështjeve të hetuara sipas kategorive të veprave, krahasuar me numrin e përgjithshëm të çështjeve të prokurorisë përkatëse.
345. Numri i çështjeve të papërfunduara brenda vitit kalendarik nga këto njësi sipas kategorisë së veprës penale.
346. Trajnimet e ndjekura nga anëtarët e këtyre seksioneve/task forcave, në lidhje me hetimin e krimeve komplekse dhe përdorimin e metodave moderne të analizës penale.

(ii) Vlerësimi

347. Rekomandimi konsiderohet i **përmbyshur** kur:



- a. Në kuadër të prokurorive janë ngritur njësi/task forca të specializuara për hetimin e krimeve komplekse si: korrupsioni, krimi ekonomik, mashtrimi, krimet e organizuara të dhunshme, terrorizmi.
- b. Këto njësi kanë trajtuar të paktën x raste komplekse gjatë 12 muajve të fundit, x% krahasuar me numrin e çështjeve të përgjithshme të prokurorisë.
- c. Numri i çështjeve të papërfunduara brenda vitit kalendarik nga këto njësi është ulur me x% krahasuar me vitin paraardhës.

348.Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Janë themeluar njësi/task forca të specializuara, por jo plotësisht funksionale ose vetëm në një pjesë të prokurorive përkatëse.
- b. Rastet komplekse x-x janë trajtuar, ose me x-x% krahasuar me numrin e çështjeve të përgjithshme të prokurorisë.
- c. Numri i çështjeve të papërfunduara brenda vitit kalendarik nga këto njësi është reduktuar me x-x% krahasuar me vitin paraardhës ose pa reduktim të konsiderueshëm.

349. Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

350. Nuk është themeluar asnjë njësi/task forcë me kompetencë të specializuar për hetime të tilla.

351. Nuk ka asnjë provë të trajtimit të çështjeve specifike të këtij lloji ose nuk është vërejtur asnjë reduktim i numrit të çështjeve të prapambetura.

352. Nuk ka të dhëna për çështje specifike të papërfunduara brenda vitit kalendarik nga këto njësi të specializuara.

(ff) çështjet penale të pezulluara

353.Rekomandohet që PP dhe SPAK të shqyrtojnë kapacitetet dhe mjetet përkatëse të nevojshme për kryerjen e hetimeve, si dhe të miratojnë një strategji, e cila i jep përparësi çështjeve të pezulluara të cilat janë vazhdimisht në rritje.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

354.Numri i çështjeve të pezulluara brenda një viti kalendarik sipas kategorisë së veprave penale.

355. Përqindja e këtyre çështjeve krahasuar me numrin total të procedimeve penale të regjistruara.



356. Burimet logjistike dhe teknologjike në dispozicion për hetimet penale tek prokurorët e juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK.

357. Ekzistenca dhe përmbajtja e një strategjie të miratuar për trajtimin e çështjeve të pazgjidhura.

358. Masat konkrete të vëna në zbatim, për sa i përket zbatimit të strategjisë për prioritizimin e hetimit të çështjeve të pazgjidhura.

359. Numri i çështjeve për të cilat është kërkuara pushimi për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit.

(ii) **Vlerësimi**

360. Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur;

- a. një numër x çështjesh, rezulton të jetë pezulluar brenda vitit kalendarik
- b. është miratuar dhe zbatuar një strategji për prioritizimin e çështjeve të pazgjidhura dhe është dokumentuar zbatimi i saj;
- c. numri i rasteve të pazgjidhura është ulur ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar;
- d. një numër x% më i lartë çështjesh është referuar për pushim për shkak të afatit të parashkrimit.

361. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur;

- a. strategjia është hartuar, por ende nuk është miratuar ose zbatuar plotësisht
- b. është kryer një vlerësim i kapacitetit, por nuk është ndjekur me masa konkrete;
- c. Reduktimi i çështjeve të pazgjidhura ose kohës së hetimit ka qenë modest dhe jo i qëndrueshëm;

362. Rekomandimi konsiderohet **papërmbushur** kur;


- a. nuk është kryer asnjë vlerësim i kapaciteteve njerëzore ose logjistike;
- b. nuk është hartuar ose miratuar asnjë strategji për çështjet e pazgjidhura;
- c. nuk ka pasur ulje të numrit të çështjeve të pazgjidhura;
- d. nuk është marrë asnjë masë për të përmirësuar trajtimin e çështjeve të pazgjidhura.

(gg) **Zhvillimi i njohurive dhe ekspertizës specifike**

363. Për të rritur efikasitetin dhe për të thelluar veprimet hetimore, rekomandohet rritja e përdorimit të njohurive dhe ekspertizës së veçantë nga strukturat ekzistuese, të specializuara në fusha që lidhen me hetimin e veprave penale përkatëse.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen**

364. Numri i rasteve në të cilat është përdorur ekspertizë e veçantë në hetime në total.



365.Numri i çështjeve në të cilat janë angazhuar struktura të specializuara për çështje penale specifike.

366.Numri i marrëveshjeve ndërinstytucionale për bashkëpunim me njësi ose agjenci të veçanta ekspertize.

(ii) **Vlerësimi**

367.Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- a. përdorimi i ekspertizës së veçantë nga strukturat ekzistuese është rritur me mbi x% krahasuar me periudhën e mëparshme;
- b. të gjitha prokuroritë kanë përdorur struktura të specializuara në të paktën X raste që kërkojnë ekspertizë specifike;
- c. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë zyrtarizuar me të paktën X njësi/struktura ekspertize.

368.Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. është rritur përdorimi i ekspertizës në disa prokurori, por mbetet i ulët në të tjera;
- b. strukturat e specializuara janë përdorur në më pak se x raste, ose për raste të kufizuara në shumëllojshmërinë e tyre;
- c. Bashkëpunimi me njësitë e ekspertizës mbetet i natyrës joformale ose sporadike.

369.Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. nuk ka asnjë ndryshim në përdorimin e ekspertizës së veçantë në krahasim me vitin e kaluar;
- b. mungon angazhimi i strukturave të specializuara në veprimet hetimore;
nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të forcuar bashkëpunimin me njësitë e ekspertizës.

(hh) **Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore**


370.Në koordinim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), rekomandohet rritja e efikasitetit në shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve njerëzore, për të rritur shkallën e suksesit të ndjekjeve penale.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen**

371.Numri i prokurorëve dhe stafit mbështetës nga prokuroritë dhe ngarkesa e tyre aktuale e çështjeve.

372.Raportet vjetore mbi analizën e burimeve njerëzore dhe vendimet për rialokimin e tyre.

373.Numri i çështjeve të përfunduara për prokuror krahasuar me vitin e kaluar.



374.Raportime mbi kohëzgjatjen mesatare të hetimeve dhe efikasitetin e zgjidhjes së çështjeve.

375.Të dhëna për rastet kur është arritur një përmirësim i ndjeshëm i performancës pas rialokimit të burimeve.

(ii) **Vlerësimi**

376.Rekomandimi konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

377.në të gjitha prokuroritë është kryer një analizë sistematike vjetore e nevojave dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore;

378.Numri i çështjeve të përfunduara për prokuror është rritur me mbi x% ose me X raste krahasuar me vitin e kaluar.

379.Në të paktën X prokurori, janë marrë masa konkrete për të rialokuar burimet në përputhje me ngarkesën e punës dhe nevojat.

380.Kohëzgjatja mesatare e hetimeve është ulur me X muaj ose x% pas rialokimit të burimeve.

381.Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Analizat e burimeve njerëzore janë kryer vetëm në disa prokurori, pa mbulim të plotë kombëtar;
- b. përmirësimet në performancë janë të kufizuara në disa zyra ose nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me rishpërndarjen e burimeve;
- c. numri i çështjeve të përfunduara për prokuror është rritur me më pak se X raste ose x%;
- d. kohëzgjatja mesatare e hetimeve nuk është ulur ndjeshëm në shumicën e prokurorive.

382.Rekomandimi konsiderohet i **papërmbushur** kur:

- a. nuk është kryer asnjë analizë mbi shpërndarjen aktuale të burimeve njerëzore;
- b. nuk është marrë asnjë masë, për të përshtatur burimet njerëzore në lidhje me nevojat reale;
- c. nuk ka ndryshim në numrin e çështjeve të përfunduara për prokuror;
- d. kohëzgjatja e hetimeve ka mbetur e njëjtë ose është rritur në raport me vitin e kaluar.

(ii) **Miratoni modele standarde të dokumenteve administrative për të unifikuar praktikat e prokurorive**

383.Shqyrtimi i mundësisë së miratimit të modeleve standarde të dokumenteve administrative të punës së përditshme të prokurorëve dhe prokurorive, me qëllim të reduktimit të kohës për kryerjen e veprimeve



hetimore, unifikimit të procedurave dhe veprimeve konkrete gjatë punës, rritjes së efikasitetit të veprimtarisë, si dhe reduktimit të veprimeve të nevojshme.

(i) **Të dhënat që duhet të mblidhen**

384. Lista e dokumenteve që përmbahen në dosjen e prokurorisë sipas natyrës së punës.

385. Llojet e akteve sipas ndarjes në akte procedurale dhe dokumenta administrativë.

386. Numri i shablloneve standarde të krijuara dhe të miratuara nga organet përkatëse për dokumentat administrative.

387. Lista e të dhënave/ që duhet të përmbahen në aktet procedurale në varësi të aktit procedural.

388. Vlerësimet e brendshme për unifikimin e praktikave të punës gjatë përdorimit të shablloneve standard.

(ii) **Vlerësimi**

389. Rekomandimi konsiderohet i **përmbushur** kur:

- a. Modelet standarde janë krijuar dhe miratuar për të paktën x dokumente kryesore administrative;
- b. Është hartuar një listë e të dhënave që duhet të përmbahen në një akt të caktuar procedural për x akte të ndryshme procedurale;
- c. shkalla e unifikimit të procedurave dhe praktikave të punës është rritur ndjeshëm sipas vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme.

390. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. Modelet standarde janë krijuar vetëm për x% të dokumenteve, por nuk janë miratuar ose zbatuar gjerësisht;
- b. Ekzistojnë pjesërisht modele të përmbajtjes së disa nga aktet kryesore procedural, ose nuk ka të dhëna të plota;
- c. Unifikimi i praktikave mbetet joformal ose i pjesshëm, pa masa për zbatimin e detyrueshëm të standardeve.

391. Rekomandimi konsiderohet i **papërmbushur** kur:

- a. nuk janë hartuar ose miratuar modelet standarde për dokumentet e përditshme të punës;
- b. nuk ka një model rekomandues për përmbajtjen e akteve procedurale



- c. praktikat e punës vazhdojnë të jenë të fragmentuara dhe jo të unifikuara në mungesë të standardizimit.

(jj) Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

392. Në koordinim me Shkollën e Magjistraturës për Trajnim të Vazhdueshëm, rekomandohet rritja e rolit të PP-së dhe SPAK-ut në zhvillimin e trajnimeve të rregullta, me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto trajnime duhet të zhvillohen rregullisht dhe duhet të standardizohen për të përshtatur njohuritë e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në mënyrë që të kryejnë veprime hetimore.

393. Trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional i prokurorëve janë thelbësorë për të siguruar kompetencën dhe efektivitetin e tyre në trajtimin e rasteve komplekse, veçanërisht ato që lidhen me korrupsionin. Programet e edukimit të vazhdueshëm duhet të përmirësohen, duke u fokusuar në zhvillimet më të fundit ligjore, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në punën e prokurorëve. Duhet të shqyrtohen mundësi për të zgjeruar temat e trajnimit, për të marrë njohuri të specializuara dhe gjithëpërfshirëse për kategori të caktuara të veprave penale, si dhe për të shumëfishuar subjektet që ofrojnë trajnime, krahas Shkollës së Magjistraturës.

(i) Të dhënat që duhet të mbliidhen

394. Numri i trajnimeve të organizuara nga PP-ja dhe SPAK-u me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
395. Shpeshësia e trajnimeve të kryera gjatë një periudhe të caktuar.
396. Numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të trajnuar sipas programeve të standardizuara.
397. Shkalla e përfshirjes së moduleve të standardizuara në programet e trajnimit.
398. Numri dhe temat e trajnimeve të kryera për prokurorët.
399. Numri i prokurorëve që kanë ndjekur trajnime për çështje korrupsioni ose çështje komplekse.
400. Shkalla e përfshirjes së temave të reja dhe të specializuara në programet e trajnimit.
401. Numri i institucioneve të tjera që kanë ofruar trajnime krahas Shkollës së Magjistraturës

(ii) Vlerësimi

402. Rekomandimi konsiderohet i **përmbushur** kur:

- a. x trajnime janë zhvilluar me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- b. mbi x/x% e prokurorëve aktivë dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë trajnuar;



- c. programet e trajnimit janë standardizuar dhe të njëjtat module janë përdorur në të gjitha seancat e trajnimit;
- d. vlerësimet pas trajnimit tregojnë një rritje të njohurive praktike dhe përmirësimin e aftësive hetimore të pjesëmarrësve.
- e. mbi x trajnime janë zhvilluar me fokus rastet komplekse dhe veprat e korrupsionit;
- f. mbi x/x% e prokurorëve janë trajnuar për tema prioritare të identifikuara sipas nevojave të sistemit;
- g. mbi x institucione të tjera krahas Shkollës së Magjistraturës janë përfshirë në ofrimin e trajnimit;
- h. programet e trajnimit janë përditësuar me temat më të fundit ligjore dhe praktikat ndërkombëtare.

403.Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- a. trajnimet janë organizuar në mënyrë të shpërndarë dhe të parregullt ose më pak se x trajnime;
- b. vetëm një pjesë e stafit është trajnuar dhe pa mbulim të plotë të strukturave hetimore ose më pak se x% e numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore;
- c. nuk ka ende një standard të unifikuar të moduleve për të gjitha trajnimet;
- d. ndikimi në cilësinë e hetimeve është i pjesshëm dhe jo i matshëm në të gjitha rastet;
- e. trajnimet janë zhvilluar me fokus të kufizuar në tema përkatëse;
- f. midis x%-x% e prokurorëve janë trajnuar për raste komplekse ose korrupsioni;
- g. subjektet e përfshira përveç Shkollës së Magjistraturës janë të pakta dhe jo të vazhdueshme;
- h. temat e trajnimit janë të pjesshme ose jo të përditësuara me zhvillimet më të fundit.

404.Rekomandimi konsiderohet **i papërmbushur** kur:

- a. trajnimet e organizuara nga PP-ja ose SPAK-u mungojnë ose janë të papërfillshme në numër;
- b. pjesëmarrja e prokurorëve dhe e oficerëve të policisë gjyqësore është shumë e ulët ose e padokumentuar;
- c. nuk ka standardizim të moduleve të trajnimit;
- d. nuk ka të dhëna mbi ndikimin e trajnimeve në përmirësimin e hetimeve;
- e. mungon trajnime të specializuara për raste korrupsioni ose raste komplekse;





- f. pjesëmarrja e prokurorëve në programet e edukimit të vazhdueshëm është shumë e ulët, nën x%;
- g. nuk ka diversifikim të rremave të trajnimit dhe ofruesve të tyre;
- h. përmbajtja e programeve të trajnimit nuk pasqyron zhvillimet ligjore dhe standardet ndërkombëtare.


(kk) Trajnimi vazhdues i prokurorëve

405. Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore duhet t'u ofrohen mundësi për t'u specializuar në fusha kyçe, të tilla si anti-korrupsioni, krimet financiare, krimet kibernetike/kompjuterike dhe krimi i organizuar, përmes moduleve të avancuara të trajnimit dhe seminareve. Për më tepër, mund të inkurajohen bashkëpunimi ndërkombëtar dhe programet e shkëmbimit, duke i lejuar prokurorët të fitojnë njohuri nga juridiksione të tjera dhe të ndajnë përvojat, duke pasuruar kështu aftësitë e tyre profesionale.

406. Forcimi i specializimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore është thelbësor për të siguruar një sistem drejtësie efikas dhe që përshtatet. Në një mjedis ku veprimtaria kriminale, veçanërisht në fusha të tilla si korrupsioni, krimi financiar dhe krimet kibernetike, po bëhet gjithnjë e më i sofistikuar, është thelbësore që profesionistët ligjorë (juristët) të kenë njohuri të përditësuara dhe aftësi të avancuara. Programet e trajnimit të mirëstrukturuara, ekspozimi ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare dhe mundësitë për specializim, jo vetëm që rrisin kapacitetin për të hetuar dhe ndjekur çështje komplekse, por gjithashtu nxisin qëndrueshmëri dhe cilësi më të madhe në procedurat ligjore. Përmes krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës të mbledhjes së të dhënave mbi trajnimin dhe pjesëmarrjen, institucionet mund të identifikojnë boshllëqet, të matin progresin dhe të përshtatin iniciativat e ardhshme për të adresuar sfidat në zhvillim, duke përforcuar përfundimisht besimin e publikut në sundimin e ligjit.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

- 407. Numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të trajnuar në secilën fushë të specializuar.
- 408. Numri i moduleve të avancuara dhe seminareve të zhvilluara për temat përkatëse.
- 409. Numri i programeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të përfunduara.
- 410. Juridiksionet e përfshira dhe lloji i përvojës së shkëmbyer përmes këtyre programeve.



411. Shpeshtësia dhe koha mesatare e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare ose të specializuara.

(ii) **Vlerësimi**

412.Rekomandimi konsiderohet i **përbushur** kur:

- a. mbi x prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore janë trajnuar në secilën nga fushat e mëposhtme: kundër korrupsionit, krimit financiar, krimit kibernetik dhe krimit të organizuar;
- b. janë zhvilluar mbi x module trajnimi të avancuar dhe seminare të dedikuara për fushat përkatëse;
- c. janë zbatuar mbi x programe shkëmbimi me juridiksione të huaja;
- d. pjesëmarrësit në programet ndërkombëtare përbëjnë mbi x/x% të numrit të përgjithshëm të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

413.Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përbushur** kur:

- a. numri i pjesëmarrësve në trajnim për secilën fushë është i kufizuar dhe i pabarabartë;
- b. janë zhvilluar vetëm disa module të avancuara ose seminare në fusha përkatëse;
- c. janë zbatuar vetëm pak ose programe ndërkombëtare të izoluara, pa një ndikim të qartë në praktikën vendase;
- d. Pjesëmarrja në shkëmbime ndërkombëtare është nën x/x% të stafit përkatës.

414.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

415.mungon trajnimi i specializuar për fushat e identifikuara si prioritete;

416.nuk janë zhvilluar module të avancuara ose seminare me përmbajtje të dedikuar;

417.nuk është zhvilluar asnjë formë shkëmbimi ndërkombëtar ose bashkëpunimi praktik;

418.Mungon dokumentimi i përvojës së fituar ose nuk ka ndikim të evidentuar në raporte në praktikën juridike.

(II) **Trajnim mbi standardet dhe procedurat e BE-së**

419.Rekomandohet rritja e rolit të PP-së dhe SPAK-ut në ofrimin e trajnimit për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore mbi standardet dhe procedurat e BE-së, në lidhje me ekstradimin dhe ndihmën juridike reciproke, veçanërisht pasi Shqipëria është në një fazë të avancuar të integritimit të saj në Bashkimin Evropian.



420. Forcimi i trajnimit mbi standardet dhe procedurat e BE-së është thelbësor për të siguruar që organet e prokurorisë dhe ato gjyqësore të Shqipërisë, të veprojnë në përputhje me normat evropiane, veçanërisht ndërsa vendi përparon drejt integritimit në BE. Trajnimi gjithëpërfshirës fuqizon prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për të trajtuar në mënyrë efikase çështjet ligjore ndërkufitare, të tilla si ekstradimi dhe ndihma juridike reciproke, duke i njohur ata me praktikatat më të mira dhe zhvillimet më të fundit në ligjin evropian. Kjo jo vetëm i jep shtysë sigurisë juridike dhe drejtësisë procedurale, por gjithashtu nxit besimin e ndërsjellë dhe përputhshmërinë operationale me vendet anëtare të BE-së, duke hapur rrugën për një bashkëpunim më të pandërprerë dhe duke forcuar besueshmërinë e Shqipërisë si një partner i besueshëm në skenën evropiane.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

421. Numri i trajnimeve të kryera mbi standardet dhe procedurat e BE-së për ekstradimin dhe ndihmën juridike reciproke.
422. Numri i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që marrin pjesë në trajnime në raport me numrin e përgjithshëm të synuar.
423. Lista e moduleve të përdorura në trajnime dhe përputhshmëria e tyre me standardet e BE-së.
424. Numri i bashkëpunimeve ose marrëveshjeve me institucionet e BE-së ose aktorët ndërkombëtarë për ofrimin e këtyre trajnimeve.

(ii) Vlerësimi

425. Rekomandimi konsiderohet i **përbushur** kur:

- a. janë kryer mbi x trajnime specifike për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë juridike sipas standardeve të BE-së;
- b. mbi x/x% e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të synuar kanë marrë pjesë në trajnim;
- c. përmbajtja e moduleve është në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së dhe është miratuar nga partnerët ndërkombëtarë;
- d. janë zyrtarizuar bashkëpunimet me të paktën x institucione të BE-së ose organizata ndërkombëtare për ofrimin e trajnimeve.

426. Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i përbushur** kur:



- a. janë kryer trajnime të kufizuara;
- b. pjesëmarrja në trajnim është nën x/x% të stafit të synuar;
- c. disa module përditësohen sipas standardeve të BE-së, por të tjerët jo;
- d. bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për zbatimin e trajnimeve është sporadik ose joformal.

427.Rekomandimi konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. nuk janë kryer trajnime të specializuara për procedurat e ekstradimit dhe ndihmës juridike të BE-së;
- b. nuk ka pjesëmarrje të dokumentuar të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në këtë fushë;
- c. përmbajtja e moduleve të trajnimit është e paqëndrueshme ose inekzistente;
- d. nuk ka asnjë formë bashkëpunimi me institucionet e BE-së ose aktorë të tjerë për këtë qëllim.

428.Seksionet e mëposhtme trajtojnë përdorimin e **metodave moderne hetimore**.

(mm) Intensifikimi i përdorimit të metodave moderne dhe të veçanta hetimore

429.Rekomandohet që prokuroria të intensifikojë përdorimin e metodave hetimore moderne, me qëllim rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave komplekse.

430.Rëndësia e intensifikimit të përdorimit të metodave moderne hetimore nuk mund të ekzagjerohet, veçanërisht në një epokë ku rrjetet kriminale përdorin taktika gjithnjë e më të sofistikuar për t'iu shmangur zbulimit. Duke i pajisur prokurorët me mjete të avancuara si mbikëqyrja elektronike, analiza financiare dhe hetime të përbashkëta, prokuroria pozicionohet më mirë për të zbuluar skemat komplekse kriminale që shtrihen përtej kufijve dhe juridiksioneve. Këto metoda jo vetëm që rrisin saktësinë dhe thellësinë e hetimeve, por gjithashtu kontribuojnë në mbledhjen në kohë dhe efektive të provave, gjë që është thelbësore për ndjekje penale të suksesshme. Në fund të fundit, përqafimi i këtyre qasjeve moderne nxit besim më të madh të publikut në sistemin e drejtësisë, përforcon sundimin e ligjit dhe promovon bashkëpunim më të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër krimeve të rënda.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen



431. Të dhëna në lidhje me numrin e rasteve të përdorimit të metodave moderne hetimore nga prokuroria për ndjekjen penale të veprave komplekse dhe llojin e metodave të përdorura (përgjime, mbikëqyrje elektronike, analiza financiare, hetime të përbashkëta, etj.)
432. Sa është përqindja e rasteve ku janë përdorur metoda moderne/speciale të hetimit (përgjime, infiltrime, hetime financiare, etj.) krahasuar me numrin e përgjithshëm të çështjeve penale të hetuara? A është rritur numri i rasteve që përdorin metoda moderne dhe speciale të hetimit krahasuar me vitin paraardhës? Cilat janë llojet më të përdorura të metodave dhe në cilat kategori të veprave penale përdoren më shpesh?
433. A janë aplikuar këto metoda në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut? A ekzistojnë dokumenta të organizatave ndërkombëtare që kanë analizuar përputhshmërinë e praktikave hetimore me standardet e njohura ndërkombëtare, përfshirë kornizat normative dhe praktikatat e rekomanduara nga institucionet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare?
434. Në sa raste të përdorimit të këtyre metodave, procedimi penal ka përfunduar dhe është dërguar për gjykim me persona të pandehur (efekti i përdorimit të këtyre metodave dhe numrit të rasteve të përfunduara me sukses).

(ii) **Vlerësimi**

435.Rekomandimi do të konsiderohet **plotësisht i përmbushur** kur:

- Të paktën ____% e numrit të rasteve komplekse gjatë vitit prokurorët kanë përdorur të paktën një metodë moderne hetimore;
- Përdorimi i metodave moderne hetimore është rritur me ____%, krahasuar me vitin e kaluar;
- Në të paktën ____% të rasteve, përdorimi i metodave moderne ka kontribuar drejtpërdrejt në ndjekjen penale ose vendimin gjyqësor;
- Në të paktën ____% të rasteve, përdorimi dokumentohet si në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Ekzistojnë udhëzime të përditësuara dhe janë zhvilluar trajnime për përdorimin e standardeve procedurale ndërkombëtare.

436.Rekomandimi do të konsiderohet **pjesërisht i përmbushur** kur:

- Në të paktën ____%- ____% të rasteve komplekse, prokurorët kanë përdorur metoda moderne,



- b. Rritja krahasuar me vitin e kaluar është ____%-____%
- c. Kontributi në vendimin e prokurorisë/ gjyqësorit është i dukshëm në ____%-____% të rasteve.
- d. Në ____% - ____% të rasteve, përdorimi i metodave moderne hetimore është i dokumentuar;
- e. Udhëzimet dhe trajnimet janë miratuar nga struktura përkatëse, por ka pasur vështirësi në zbatimin dhe ndjekjen e tyre.

437.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërbushur** kur:

- a. Në më pak se ____% të rasteve komplekse, prokurorët përdorin metoda moderne.
- b. Rritja krahasuar me vitin e kaluar është më e vogël se ____% ose nuk ka fare rritje.
- c. Më pak se ____% e rasteve tregojnë një ndikim pozitiv të metodës moderne në përfundimin e çështjes.
- d. Nuk janë marrë masa konkrete për përditësimin e praktikave dhe trajnimeve

(pp) Përmirësoni infrastrukturën teknologjike

438. Rekomandohet përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në prokuroritë.

439. Adresimi i këtyre pikave është thelbësor sepse efikasiteti i ndjekjes penale varet gjithnjë e më shumë nga vënia në zbatim e metodave të avancuara hetimore dhe infrastrukturës së fuqishme teknologjike. Metodatat moderne – të tilla si mbikëqyrja elektronike, analiza financiare dhe hetimet e përbashkëta – mund të rrisin ndjeshëm aftësinë e prokurorëve për të trajtuar çështje komplekse, për të identifikuar modelet e sjelljes kriminale dhe për të siguruar prova të besueshme. Në të njëjtën kohë, sistemet e teknologjisë së informacionit të zhvilluara mirë janë thelbësore për menaxhimin efikas të çështjeve, ruajtjen e sigurt të të dhënave të ndjeshme dhe komunikimin e shpejtë ndërinsitucional. Pa përmirësime në këto fusha, prokuroria mund të përballet me pengesa në luftimin e krimeve të sofistikuar, sigurimin e drejtësisë dhe ruajtjen e besimit të publikut.

(i) Të dhënat që duhet të mblidhen

440.Cila është gjendja aktuale e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në sistemet e prokurorisë?

Sa është investuar në këtë drejtim dhe cilat janë projeksionet buxhetore të organit të prokurorisë për përmirësimin e teknologjisë së informacionit?



441.A është përmirësuar ndjeshëmi infrastruktura e teknologjisë së informacionit në prokurori dhe a ka kontribuar kjo në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së proceseve hetimore dhe administrimit të çështjeve penale?

442.A janë marrë masa konkrete për modernizimin e rrjeteve kompjuterike dhe përmirësimin e kapaciteteve të ruajtjes dhe aksesit në të dhënat dixhitale?

443.A ekziston një sistem i integruar për menaxhimin e çështjeve, dokumentacionit dhe komunikimit ndërinstitucional?

444.A është rritur niveli i sigurisë kibernetike dhe a janë zvogëluar ndërprerjet ose vështirësitë teknike në funksionimin e prokurorëve?

(ii) **Të dhënat që duhet të mbliidhen**

445.Rekomandimi do të konsiderohet i **përmbyshur plotësisht** kur:

- a. Investime të prekshme në infrastrukturë janë bërë në të paktën 30% të zyrave të Prokurorive, të dokumentuara nga raportet zyrtare;
- b. Ka pasur një rënie prej mbi 50% të ndërprerjeve teknike ose problemeve të raportuara në funksionimin e IT-së në zyrat e Prokurorisë.

446.Rekomandimi do të **konsiderohet i përmbyshur pjesërisht** kur:

- a. Investimet e parashikuara për përmirësimin e teknologjisë së informacionit janë realizuar në masën 15% - 20%.
- b. Zbatimi i sistemit të integruar të menaxhimit elektronik të çështjeve është në fazën e pilotimit dhe testimit nëse përmbysh kriteret e parashikuara nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- c. Ulja e incidenteve teknike ka pësuar një rënie prej 20% - 25% gjatë këtij viti.

447.Rekomandimi do të konsiderohet i **papërmbyshur** kur:

- a. Ndërhyrjet dhe përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit janë realizuar në më pak se 10% të Prokurorive;
- b. Sistemi i integruar i menaxhimit të çështjeve nuk është funksional dhe nuk i përmbysh kërkesat e parashikuara nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet drejtuese të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;



- c. Nuk ka asnjë përmirësim të matshëm në funksionalitetin dhe sigurinë e infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit.

(qq) Përdorimi i Inteligjencës Artificiale

448. Rekomandohet të rritet përdorimi i teknologjive bashkëkohore të njohura, përfshirë inteligjencën artificiale, për analizimin dhe krahasimin e të dhënave të mbledhura, me qëllim sigurimin e shpejtësisë në kryerjen e veprimeve hetimore.
